



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

R A P O R T I
I PUNËS SË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT
PËR VITIN 2022

Shkup, viti 2023

HYRJE

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me Rendin kushtetues dhe ndarjen e pushteteve në ligjvënës, ekzekutiv gjyqësor është gjykata më e lartë në Republikën që siguron zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat dhe është bartëse e pushtetit gjyqësor.

Në vitin raportues 2022 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore i realizoi me një numër të zvogëluar të gjyqtarëve dhe të nëpunësve gjyqësor.

Edhe krahas kushteve të këtilla rënduese, sipas Ligjit të gjykatave, në suaza të **kompetencës reale** të saj, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjykatë më e lartë vendos në shkallën e tretë dhe të fundit për ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit, për mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të tyre, kur ajo është e paraparë me ligj, për ndeshje të kompetencave dhe për përcaktimin e kompetencës vendore, vendos për kërkesa për cenimin e të drejtës së gjykimit në afatin e arsyeshëm, në shkallën e parë dhe të dytë, në procedurë të shënuar me ligj në gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me rregullat dhe principet e shënuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njerëzve dhe Lirive Themelore dhe duke u nisur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve dhe çështje tjera të shënuara me ligj.

Kompetencën e saj, Gjykata e realizon përmes **Sektorit të veprave penale, Sektorit të veprave civile, Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm, këshillave të specializuara për procedimin** e kërkesave për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën, për ankesat e kandidatëve të cilët nuk janë zgjedhur për gjyqtarë, respektivisht për Kryetarë gjykate dhe për ankesa kundër vendimeve të Këshillit gjyqësor për refuzimin ose pranimin e kundërshtimit ose vendimit për rivlerësimin e gjyqtarit ose Kryetarit të gjykatës.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, **kompetencën e saj kushtetuese për sigurimin e zbatimit të unifikuar të ligjeve nga gjykatat** në Republikën e Maqedonisë së Veriut, fillimisht e realizon përmes punës së **Seancës së përgjithshme**, kompetenca e të cilës është definuar sipas Ligjit për gjykatat ku është paraparë se miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore për çështje me rëndësi për sigurimin e unifikuar në zbatimin e ligjeve nga gjykatat, me iniciativë nga avokatë, jep mendime për propozime të ligjeve dhe rregulla tjera kur me ato rregullohen çështje me rëndësi për punën e gjykatave, shqyrton çështje lidhur me punën e gjykatave, zbatimin e ligjeve dhe praktikën gjyqësore, emëron përbërjen e këshillit për vendimmarrjen e ankesave kundër aktvendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkarkimin e gjyqtarit ose për masën e shqiptuar disiplinore ku marrin pjesë nga tre gjyqtarë nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut të zgjedhur me anë të shortit dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Kompetenca për unifikimin e praktikës gjyqësore realizohet edhe përmes punës së **Sektorit të praktikës gjyqësore** dhe të **seancave të sektorëve gjyqësorë** në të cilat miratohen mendime juridike, nxirren konkluzione dhe përcaktohen sentenca.

Sipas **parimit të transparencës**, qëndrimet parimore dhe mendimet juridike parimore, mendimet juridike, konkluzionet, sentencat dhe njoftimet nga kompetenca e Seancës së përgjithshme dhe seancave të sektorëve rregullisht publikohen në ueb faqen e Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës Supreme i ka plotësuar kompetencat e tij si anëtar i funksionit në Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit të buxhetit gjyqësor, dhe sipas Ligjit dhe Rregullores gjyqësore i realizoi të gjitha kompetencat e **administratës gjyqësore**, dhe po ashtu rregullisht realizoi komunikim dhe bashkëpunim me gjykatat, institucionet vendore, organizatat joqeveritare dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare.

Në plotësim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Kryetari dhe të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë marrë pjesë në punën e Seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, seancën e sektorëve, punën në këshillat, si dhe në aktivitete tjera në pajtim me ligjin, të orientuara në zbatimin më efikas të Kushtetutës, ligjeve marrëveshjet kolektive ndërkombëtare dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim të Kryetarit të gjykatës është formuar Trupi punues për standardizimin e përdorimit dhe përparimit të programit AKMIS në gjykatat që menaxhohet nga një gjyqtar të Gjykatës Supreme në seancat e të cilave është vendosur mbi kërkesa konkrete nga gjykatat lidhur me zbatimin e programit AKMIS.

Gjatë vitit rregullisht është vepruar edhe për kërkesat e palëve sipas Ligjit për qasje të lirë në informacionet me karakter publik.

Kuadri ekzistues profesional dhe administrativ krahas angazhimit të këshillave gjyqësore, sipas Orarit të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore për vitin 2022 aktivitet të rëndësishëm treguan edhe me pjesëmarrjen në edukimet e organizuara nga Akademia e gjyqtarëve dhe Prokurorëve publikë si dëgjues, por edhe si edukatorë në temat nga Programi për trajnim të Akademisë.

Sipas Ligjit për gjykatat në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është formuar dhe funksionon qendra e informatikës me bazën e të dhënave për teknologji informatike, kompetente për menaxhimin teknik të sistemit kompjuterik për menaxhimin me lëndët gjyqësore dhe bazat e të dhënave që rezultojnë nga puna e gjykatave.

Vëllimi dhe intensiteti i punës është shprehur përmes të dhënave për veprimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuadër të kompetencës së tij dhe përmes të dhënave të punës së sektorëve dhe këshillave të specializuara për lëndë konkrete gjatë tërë vitit dhe aktivitete tjera dhe masa të cilat janë ndërmarrë në Gjykatë, si gjykatë më a lartë në Republikën.

ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në vitin 2022 Kryetari i Gjykatës veprimi për të gjitha lëndët e administratës gjyqësore.

Të dhënat nga Administrata gjyqësore nga fushëveprimi i punës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë shfaqur në Tabelën në vijim:

Sfera	Administrata gjyqësore						
Lloji i lëndës	Evidenca e administratës gjyqësore						
Nënllloji i lëndës	Të pa kryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuar a gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të administratës gjyqësore	0	2790	0	0	2790	2790	0
Gjithsej – lloji i lëndës	0	2790	0	0	2790	2790	0
Lloji i lëndës	Parashtresa dhe ankesa						
Nënllloji i lëndës	Të pa kryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuar a gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Qasje të lirë në informacione	0	26	0	0	26	26	0
Evidenca e parashtresave dhe ankesave	0	136	0	0	136	136	0
Gjithsej – lloji i lëndës	0	162	0	0	162	162	0
Gjithsej - sfera	0	2952	0	0	2952	2952	0

Parashtresa, propozime dhe kërkesa tjera nga administrata gjyqësore

Gjatë vitit **2022**, në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë pranuar gjithsej 136 parashtresa të evidentuara në Regjistrin UPP.

Prej gjithsej parashtresave të parashtruara, të evidentuara në Regjistrin UPP, 85 janë kërkesa për kryerjen më të shpejtë të lëndëve, ndërsa 51 janë parashtresa nga qytetarë, institucione dhe organe tjera shtetërore.

Sipas Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari prej gjithsej 85 kërkesave të pranuar për kryerjen me prioritet të lëndëve, ka miratuar 30, ka refuzuar 35, ndërsa për lëndët tjera janë marrë informacione se lëndët janë marrë në punë, respektivisht se procedura e lëndës konkrete ka përfunduar, kurse lënda është dërguar në gjykatën më të ulët kompetente.

Prej gjithsej 136 parashtresave të dorëzuara, të evidentuara në Regjistrin UPP, janë evidentuar 3 parashtresa të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 9 parashtresa të Avokatit të Popullit dhe 2 parashtresa të Ministrisë së Drejtësisë me kërkesë për informacion lidhur me revizion të parashtruar, kohëzgjatja e procedurës dhe të tjera.

Për kërkesat e parashtruara sipas bazave të ndryshme të evidentuara në Regjistrin UPP, Gjykata supreme ka vepruar sipas Ligjit për gjykatat, Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve, sipas Rregullores së punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregullores gjyqësore dhe sipas Ligjit për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve në gjykata.

Për kërkesat e parashtruara sipas bazave të ndryshme të evidentuara në Regjistrin UPP, Gjykata supreme ka vepruar sipas Ligjit për gjykatat, Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve, sipas Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregullores gjyqësore dhe sipas Ligjit për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve në gjykata.

Kërkesa për përjashtim – SU – IZZ / 2022

Numri total i kërkesave të parashtruara për përjashtim: 156

-numri i kërkesave të parashtruara nga palët për përjashtimin e gjyqtarit; 5

-numri i kërkesave të parashtruara nga palët për përjashtimin e kryetarit të gjykatës më të ulët; 4

-numri i kërkesave të parashtruara nga gjyqtar i GJSRMV për përjashtimin e gjyqtarit; 136

-numri i kërkesave për përjashtim të parashtruara nga kryetar i gjykatës drejtuar kryetarit të gjykatës më të lartë; 11

Vendime të publikuara, të anonimizuara

Publikimi i Vendimeve, në faqen zyrtare të gjykatës zhvillohet vazhdimisht siç është paraparë në Ligjin për udhëheqje me çarkullimin e lëndëve, të shfaqur në tabelën në vijim:

Penale	332
Civile	768
Afat të arsyeshëm PSSRG- PSRRK- PSRRU	294
Ankesa në afat të arsyeshëm PSRRZH	181
USPIZH	12
UZZ	2
GJITHSEJ:	1.589

Vizita të gjykatave më të ulëta

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me kompetencën e përcaktuar në nenin 88 të Ligjit për gjykatat dhe në pajtim me kompetencën e përcaktuar në nenin 24 paragrafi (4) të Rregullores gjyqësore, me paralajmërim paraprak, më 05.12.2022 realizoi vizitë pune në Gjykatën e Apelit Shkup. Raporti për vizitën e realizuar të punës, përgatitur nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është miratuar në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 27.12.2022.

Më 14.12.2022, Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me kompetencën e përcaktuar në nenin 88 të Ligjit për gjykatat dhe në pajtim me kompetencën e përcaktuar në nenin 24 paragrafi (4) të Rregullores gjyqësore, me lajmërim paraprak, realizoi vizitë pune në Gjykatën e Apelit Shtip. Raporti për vizitën e realizuar të punës, të përgatitur nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është miratuar në Seancën e përgjithshme, të mbajtur më 27.12.2022.

MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Gjatë vitit 2022 në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut www.vsrn.mk janë publikuar 165 njoftime për publikun që kanë të bëjnë me punën dhe aktivitetet e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të cilat kanë për qëllim, në pajtim me parimin e transparencës, të informojnë për çështjet që janë në interes të publikut.

Transparenca në punën e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me Rregulloren e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut sigurohet me publikimin e vendimeve të Gjykatës dhe të dhëna më të rëndësishme në lidhje me punën e Gjykatës në ueb faqen, me dorëzimin e njoftimit zyrtar përmes mjeteve për informim publik, mbajtjen e konferencave për medime, si dhe me botimin e buletineve dhe në mënyrë tjetër. Në pajtim me nenin 78 të Rregullores

së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, njoftimet për publikun i përpilon zëdhënësi i Gjykatës Supreme.

Në ueb faqen e Gjykatës Supreme gjatë vitit 2022 janë publikuar njoftime që kanë të bëjnë me mbajtjen e Seancave të përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut; njoftimet për seancat e gjyqtarëve dhe për seancat e sektorëve të veprave civile, të veprave penale, të praktikës gjyqësore dhe për gjykim në afat të arsyeshëm dhe njoftimet që kanë të bëjnë me vendimet e Gjykatës Supreme për lëndët për të cilat ka interes nga publiku dhe mediumet, përkatësisht për lëndët me karakter publik.

Në këtë drejtim, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut publikoi njoftime për miratimin e Qëndrimit parimor për publikimin e vendimeve gjyqësore të pa plotfuqishme në ueb faqet e gjykatave dhe për dorëzimin e Iniciativës për ndryshimin e Ligjit për udhëheqjen me lëndët e gjykatave dhe të Ligjit për gjykatat në pajtim me konkluzionin e nxjerrë në Seancën e përgjithshme.

Gjithashtu, në vitin raportues Gjykata Supreme publikoi edhe njoftime për vendimet e miratuara në lidhje me lëndët me interes të lartë publik.

Në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë publikuar njoftime për intervista, paraqitjet publike dhe deklaratat e kryetarit të Gjykatës Supreme; njoftimet për pjesëmarrjen e kryetarit të Gjykatës Supreme dhe gjyqtarëve të Gjykatës Supreme në konferenca vendore dhe ndërkombëtare, tribuna simpoziume, seminare dhe ngjarje tjera; njoftime për vizita zyrtare Gjykatës Supreme nga ana e përfaqësuesve të organizatave dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, kryetarë, gjyqtarë dhe përfaqësues nga gjykatat ndërkombëtare dhe gjykatat nga vende tjera; njoftime për vizitat e përfaqësuesve të korit diplomatik; njoftime për aktivitetet e Këshillit për Gjyqësor të Hapur; njoftime nga takime pune dhe mbledhje me përfaqësues të organizatave civile, shoqata dhe sindikata; njoftime për organizime të ditëve të hapura; njoftime për konkluzione nga Seancat e përgjithshme, si dhe njoftime lidhur me aktivitete në pajtim me realizimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Njoftime për intervista, konferenca, takime, ngjarje dhe aktivitete

Intervista e kryetarit të Gjykatës Supreme, Besa Ademi, për javoren “Fokus”. Në Gjykatën Supreme janë dorëzuar mendimet e Prokurorisë Publike për lëndët “27 Prilli” dhe “Spiun”. Është publikuar Qëndrimi parimor për publikimin e vendimeve të miratuara gjyqësore në ueb faqet e gjykatave. Raporti mujor i punës së Gjykatës Supreme për muajin nëntor 2022. Takim pune i kryetarëve të Gjykatës Supreme, Këshillit gjyqësor dhe Shoqatës së gjyqtarëve. Gjykata Supreme miratoi Qëndrim parimor për publikimin e vendimeve të miratuara gjyqësore të gjykatave. Fjalimi i kryetarit të Gjykatës Supreme në Konferencën për raportet e Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë”. Kryetari i Gjykatës Supreme realizoi vizitë pune në Gjykatën e Apelit Shtip. Kryetari i Gjykatës Supreme realizoi vizitë pune në Gjykatën e Apelit Shkup. Përfaqësues të Gjykatës Supreme morën pjesë në Forumin rajonal për sundimin e të drejtës në Tiranë. Në Gjykatën Supreme qëndroi një delegacion nga Misioni i OSBE-së në Shkup.

Raporti mujor për punën e Gjykatës Supreme për muajin tetor 2022. Në Gjykatën Supreme u mbajt takim me një delegacion të Gjykatës Supreme të Uzbekistanit. Konkluzione nga Seanca e përgjithshme të mbajtura të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kryetari i Gjykatës Supreme pati fjalim në Konferencën ndërkombëtare gjyqësore për gjyqësor të pavarur.

Kryetari i Gjykatës Supreme me fjalim në Konferencën e këshillave gjyqësorë nga rajoni.

Përfaqësues të Gjykatës Supreme realizuan vizitë studiuare në Oslo për përparimin e sistemit - AKMIS Me rastin e Ditës Evropiane të Drejtësisë, nxënëses nga SEPUGS “Vasill Antevski – Dren” vizituan Gjykatën Supreme. Raporti mujor për punën e Gjykatës Supreme për muajin shtator 2022. Seanca e Tretë e Këshillit për Gjyqësor të Hapur. Në Gjykatën Supreme u mbajt takim me përfaqësues nga Këshilli i Evropës në lidhje me sistemin e ndihmës juridike pa pagesë. Në Gjykatën Supreme u mbajt takim me përfaqësues nga Këshilli i Evropës në lidhje me sistemin për ndihmë juridike pa pagesë. Një delegacion i Gjykatës Supreme morën pjesë në Konferencën rajonale për zbatimin e Konventës Evropiane. Ambasadori i BE-së, Dejvid Gir, ia dorëzoi zyrtarisht Raportin e BE-së kryetares së Gjykatës Supreme, Besa Ademi. Takim i Parë zyrtar i kryetares së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës. Ademi: Integriteti i gjyqtarit është garanci më e fuqishme ngase ai nuk do t'i nënshtrohet ndikimeve dhe presioneve. Takimi Parë protokollar i kryetares

së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Ambasadorin e Republikës së Francës.

Takim pune i kryetares së Gjykatës Supreme dhe kryetarit të UPOZ.

Kryetarja e Gjykatës Supreme pati fjalim në Tryezën e rumbullakët kushtuar parandalimit të korrupsionit në gjyqësor. Këshilli për Gjyqësor të Hapur miratoi Rregulloren e punës dhe zgjodhi bashkëkryetarë. Fjalim përshëndetës të kryetares së Gjykatës Supreme me rastin e hapjes së godinës së re të Gjykatës Administrative. Përfaqësues nga Gjykata Supreme në Konferencën rajonale për evidentimin e të dhënave statistikore për pronën e konfiskuar. Takimi i Gjykatës Supreme dhe gjykatave të apelit. Kryetarja e Gjykatës Supreme me fjalim në Konferencën rajonale për të drejtën për gjykim në afat të arsyeshëm. Konferencë rajonale për zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtën për gjykim në afat të arsyeshëm.

Kryetarja e Gjykatës Supreme në Konferencën e kryetarëve të gjykatave supreme nga Evropa Qendrore dhe Lindore në Pragë. Kryetarja e Gjykatës Supreme me fjalim përshëndetës para gjeneratës së re dëgjues në Akademinë për gjyqtarë dhe prokurorë publik. Një delegacion i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vizitë zyrtare në Gjykatën Supreme të Republikës së Serbisë. Ademi për MIA: Angazhimet tona janë shumë të qarta – standarde evropiane për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe për pavarësinë e gjyqësorit. Fjalimi i kryetares së Gjykatës Supreme në Konferencën “Gjyqësori në Maqedoninë e Veriut sipas procesit të reformave”.

Nxënës për vizitë në Gjykatën Supreme të RMV me rastin e Ditës së gjyqësorit, Deklarata e Gjyqësorit të Hapur. Është themeluar Këshilli për Gjyqësor të Hapur dhe është nënshkruar Deklarata për Gjyqësor të Hapur. Fjalimi i kryetares së Gjykatës Supreme të RMV, Besa Ademi, në Konferencën për përparimin e reformave në gjyqësorin. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut i shqyrtoi raportet e punës së gjykatave. Ademi: Po ju afrohem standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe po punojmë fort për të rikthyer besimin në gjyqësorin. Takimi bilateral i Kryetarit të Gjykatës Supreme të RMV me UD kryetar i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë realizoi takim me Koordinatorin e Lartë rajonale për Evropën nga Partneriteti për Qeveri të Hapur. Kryetari i Gjykatës Supreme me fjalim përshëndetës në Konferencën shkencore ndërkombëtare në Universitetin e Evropës Juglindore. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut morri pjesë në një Seminar të përmbauesve, të mbajtur më 26.02.2022 në Ohër. Takimi i kryetarit të Gjykatës Supreme të RMV me Shefin e sektorit politik dhe ekonomik të Ambasadës së SHBA. Një përfaqësues i Gjykatës Supreme morri pjesë në Hapjen e gjyqësorit 2022 të Gjykatës Penale ndërkombëtare në Hagë. Takimi i kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kryetarit të Gjykatës Themelore Penale Shkup.

Ditët e hapura të Gjykatës, themelimi i Këshillit për Gjyqësor të Hapur dhe ngjarje për përparimin e transparencës së gjykatave

Më 30.03.2022 në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut u themelua Këshilli për Gjyqësor të Hapur. Në kuadër të ngjarjes u nënshkrua Deklarata për Gjyqësor të Hapur. Këshilli për Gjyqësor të Hapur ka për qëllim të përforcojë transparencën dhe hapjen e gjyqësorit dhe rritjen e besimit të qytetarëve lidhur me punën e gjykatave. Kryetarja e Gjykatës Supreme, Besa Ademi, theksoi se Gjykata Supreme e RMV si bartëse e pushtetit gjyqësor ka obligimin edhe për sigurimin e zbatimit të unifikuar të ligjeve që është parakusht për drejtësi të barabartë për të gjithë qytetarët, e themeluar në praktikë të vendosur gjyqësore në mënyrë që të respektohet parimi i sigurisë juridike, por në të njëjtën kohë do të sigurohet edhe hapja e të dhënave dhe punës së gjykatave si institucione që janë kompetente për veprim të drejtë.

Puna e Këshillit për Gjyqësor të Hapur është vërejtur dhe është vlerësuar pozitivisht edhe në Raportin e fundit të Komisionit për përparimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjykata Supreme e RMV, përmes një përfaqësuesit të saj (zëdhënësit të Gjykatës Supreme) morri pjesë në trajnimet e organizuara nga OSBE-ja dhe Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë për përforcimin e kapaciteteve të Zyrës për marrëdhënie me publikun në institucionet gjyqësore dhe përparimin e komunikimit me mediumet, si dhe të ngjarjeve të organizuara nga shoqatat e gazetarëve të përkushtuar për përparimin e transparencës së gjykatave.

Zyra për marrëdhëniet me publikun nëpërmjet zëdhënësit të Gjykatës Supreme siguron komunikim të vazhdueshëm me mediumet, organizata civile dhe qytetare dhe ka bashkëpunim intensiv me Këshillin

gjqësor të medimeve në kuadër Shoqatës së gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për çështje që kanë të bëjnë me përpunimin e transparencës në pajtim me parimin për gjyqësor të hapur. Gjatë vitit 2022, Gjykata Supreme organizoi Ditë të hapura të gjykatës. Me rastin e 25 Tetorit, Ditës Evropiane të Drejtësisë Civile, nxënës nga SHMEJQSH “Vasil Antevski – Dren”, ishin për vizitë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në Gjykatën Supreme nxënësit patën mundësinë që drejtpërdrejtë të njihen me kompetencat, punën dhe organizimin e gjykatës më të lartë në shtet, si dhe me rolin dhe aktivitetet për realizimin e drejtësisë dhe sundimin e të drejtës. Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, iu tha nxënësve se nëse arsimit juridik është përcaktim i tyre në të ardhmen, duhet ta ndërtojnë me shumë përkushtim dhe se ata si gjeneratë do të përfaqësojnë të ardhmen e sistemit juridik dhe të institucioneve gjyqësore.

Me rastin e 31 marsit, Ditës së Jurisprudencës, Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut e vizituan nxënës nga Shkolla fillore “Naim Frashëri” nga Kumanova. Në Gjykatën Supreme, nxënësit u njoftuan me punën dhe kompetencat e Gjykatës Supreme si gjykatë më të lartë në shtetin dhe me funksionimin e gjyqësorit si bartëse e pushtetit që kujdeset për sigurimin dhe afirmimin e sigurisë juridike të qytetarëve.

VIZITA DHE BASHKËPUNIME NDËRKOMBËTARE

Një përfaqësues nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, morri pjesë në hapjen solemne të vitit 2022 gjyqësor në Gjykatën penale ndërkombëtare me seli në Hagë, të mbajtur më 20.01.2022 në format virtuoz;

Një delegacion i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të kryesuar nga kryetarja e gjykatës Besa Ademi, më 16.03.2022 realizoi takim bilateral me UD Kryetarin e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë;

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, më 01.04.2022 morri pjesë dhe pati fjalim në Konferencën regjionale me temë “Gjyqësori në Maqedoninë e Veriut pas procesit reformues”, që në Ditën e jurisprudencës e organizoi Shoqata e gjyqtarëve;

Kryetarja e Gjykatës Supreme, Besa Ademi, pati fjalim në Konferencën ndërkombëtare gjyqësore për pavarësinë e gjyqësorit në organizim të Shoqatës së gjyqtarëve dhe Ambasadës së SHBA-ve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në bashkëpunim me Institutin CEELI nga Praga;

Një Delegacion i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të kryesuar nga kryetarja e gjykatës, Besa Ademi, më 07.04.2022 në një vizitë zyrtare Në Gjykatën Supreme të Republikës së Serbisë;

Kryetarja e Gjykatës Supreme, Besa Ademi, morri pjesë në Konferencën e kryetarëve të gjykatave supreme nga Evropa Qendrore dhe Lindore në organizim të Institutit CEELI, që u mbajt në Pragë, në periudhën 15 – 17 Prill 2022;

Në organizim të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në bashkëpunim me Bashkimin Evropian dhe me Këshillin e Evropës në kuadër të projektit “Iniciativa për siguri juridike në Ballkanin Perëndimor” më 02 dhe 03 Qershor 2022 në Shkup, u mbajt Konferencë regjionale dyditore për zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtën për gjykim në afatin e arsyeshëm me temë “Unifikimi i zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nivel nacional dhe e drejta për gjykim në afatin e arsyeshëm”;

Përfaqësues nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 13 dhe 14 Qershor 2022 në Sarajevë, morën pjesë në Konferencën regjionale me temë “Arritja e saktë, evidentimi i standardizuar i të dhënave statistikore për pronë të konfiskuar në procedurat penale”, në organizim të Inicativës së kundër korrupsionit regjional dhe AIRE Qendrës nga Londra;

Një Delegacion tre anëtarësh të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mori pjesë në Konferencën regjionale me temë “Zbatimi i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut – përvoja dhe sfida të gjykatave në Evropën Qendrore dhe Lindore”, që u mbajt në Beograd, Republika e Serbisë më 15 dhe 16 Shtator 2022;

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, u mbajt mbledhje më 19.02.2022 me përfaqësues të Administratës gjyqësore të Holandës në kuadër të vizitës Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me donacionin e Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë për përpunimin e sistemit të ri – AKMIS;

Gjykata Supreme nëpërmjet një përfaqësuesi të saj mori pjesë në Konferencën regjionale përfundimtare të Programit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshilli i Evropës „Horizontal Facility për Ballkanin perëndimor dhe Turqinë faza II”, që u mbajt më 27-28 Shtator 2022 në Budva, Mal të Zi;

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, u mbajt takim me përfaqësues nga Këshilli i Evropës më 05.10.2022, në kuadër të projektit “Mbështetja për qasje më të mirë në shërbimet më cilësore për ndihmë juridike pa pagesë (NJP) në Maqedoninë e Veriut” (që është pjesë e programit Instrument horizontal II), të realizuar nga Këshilli i Evropës, ndërsa i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës;

Kryetarja e Gjykatës Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mori pjesë në punën e dhe pati fjalim në Konferencën e këshillave gjyqësor nga regjioni, në të cilën u këmbyen praktika pozitive për funksionimin më efikas të institucioneve gjyqësore;

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, realizoi takim me Ambasadorin e Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, E.T. Dejvid Gir më 13 Tetor 2022, në të cilën zyrtarisht iu dorëzua Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 në kuadër të procesit të qasjes në BE,

Përfaqësues nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut me ftesë të Këshillit administrativ të Norvegjisë realizuan vizitë studiuare në Gjykatën e Qarkut në Oslo për përparimin e sistemit – AKMIS;

Një Delegacion gjyqësor nga Uzbekistani më 10.11.2022 realizoi vizitë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në kuadër të vizitës studiuare të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”, Këshilli gjyqësor dhe Gjykata Supreme e RMV);

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, realizoi takim me përfaqësues nga misioni i OSBE-së në Shkup më 24.11.2022, në të cilën u prezantua “Raporti i kalimtar për mendimet dhe rekomandimet e konstatuara”, që është rezultat i Projektit regjional të OSBE-së për mbikëqyrjen e proceseve gjyqësore nga sfera e krimit të organizuar dhe korrupsionit;

Përfaqësues nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, morën pjesë në Forumin regjional për sundimin e të drejtës në Evropën juglindore, që në organizim të Qendrës AIRE u mbajt në Tiranë, Republika e Shqipërisë më 25 dhe 26 Nëntor 2022;

Përfaqësues nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut morën pjesë në Mbledhjen bilaterale për KAPITULLIN 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore, që u mbajt më 01/02 Dhjetor 2022, në Bruksel, Belgjikë;

Përfaqësues nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, realizuan vizitë studiuare në Këshillin e Evropës dhe në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg 06-07 Dhjetor, 2022;

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ambasadori i Mbretërisë së Spanjës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, z. Hose Luis Llozano Garsija, realizuan takimin e parë zyrtar në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kërkesa sipas Ligjit për qasje të lirë në informacionet me karakter publik

Numri i kërkesave të pranuar:

Në periudhën prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë pranuar gjithsej 26 kërkesa për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, nga të cilat, 11 kërkesa janë parashtruar nga persona juridik ndërsa 15 kërkesa janë parashtruar nga persona fizik.

- Numri i kërkesave me përgjigje pozitive;

Me aktvendim iu është përgjigjur pozitivisht 16 kërkesave.

1 (një) kërkesë i është ridërguar poseduesit të informacioneve sipas përmbajtjes së kërkesës në përputhje me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, për të cilën i është dërguar njoftim kërkuarit.

Për 9 (nëntë) kërkesa të parashtruara nga persona fizik që kanë të bëjnë me çështje të parashtruara që nuk kanë lidhje me qasjen e lirë në informacionet me karakter publik me njoftime iu është përgjigjur parashtruesve të kërkesave.

- Numri i kërkesave të refuzuara dhe të hedhura poshtë me theksimin e arsyeve për çdo kërkesë të refuzuar ose të hedhur poshtë;

Kërkesa të refuzuara dhe të hedhura poshtë nuk ka.

- Numri i kërkesave pa përgjigje;

Për të gjitha kërkesat për qasje të lirë në informacionet me karakter publik të pranuar në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës raportuese është vepruar dhe përgjigjur. Kërkesa pa përgjigje nuk ka.

- Numri i ankesave të parashtruara kundër vendimeve të shkallës së parë (aktvendimet e poseduesve të informacioneve, me përshkrimin e vendimit, si dhe me theksimin e arsyeve për vendimin e miratuar në rast të refuzimit përsëri të informacionit të kërkuar);

Në periudhën raportuese drejtuar Agjencisë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik ishte parashtruar një (1) ankesë nga një person fizik kundër Gjykatës Supreme për lëndë të titulluar kërkesë për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, për shkak se, siç ishte theksuar në ankesën, Gjykata Supreme nuk ka vepruar mbi kërkesën e parashtruesit në afat të paraparë ligjor.

- Numri i ankesave të miratuara me vendim të Agjencisë;

Nuk ka ankesa të miratuara me vendim të Agjencisë.

- Numri i vendimeve të ndryshuara të shkallës së parë pas veprimit të Agjencisë

Nuk ka vendime të ndryshuara pas veprimit të Agjencisë.

- Numri i ankesave të refuzuara nga Agjencia dhe shkaqet për refuzimin e tyre dhe

Ka një ankesë, e cila është refuzuar me arsyetim se poseduesi i informacionit ka vepruar për lëndën.

- Numri i ankesave të hedhura poshtë nga Agjencia dhe shkaqet për hedhjen poshtë të tyre.

Nuk ka.

Të dhënat nga Zyra për marrëdhënie me publikun

Informacionet mbi rrjedhjen e procedurave që udhëhiqen në Gjykatën, në përputhshmëri me ligjet dhe me Rregulloren gjyqësore, pyetjeve të parashtruara nga mediumet kur bëhet fjalë për lëndë që paraqesin interesim të madh nga publiku, si dhe palët që kanë interes juridik dhe çështje tjera jepen përmes info@vsrm.mk dhe portparol@vsrm.mk, përmes përgjigjeve për kërkesat për qasje të lirë në informacionet me karakter publik dhe përmes Kabinetit të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

VENDIMMARJA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut **vitin raportues 2022** e përfundoi si gjykatë efikase, **fluksi i lëndëve është tejkaluar plotësisht, ndërsa numri i lëndëve të pakryera është zvogëluar për 149 lëndë.**

Në vitin 2022 Gjykata Supreme ka pasur gjithsej **3069** lëndë në punë nga të gjitha fushat, nga të cilat **8** lëndë janë evidentuar përsëri në punë, **1** lëndë udhëhiqet si gabimisht e evidentuar.

Viti ka filluar me **956** lëndë të pakryera nga viti 2021, ndërsa gjatë vitit janë pranuar **2106 lëndë** të reja. Nga ato janë kryer **2262** lëndë, ndërsa kanë mbetur **807** lëndë të pakryera.

Raport sipas sektorëve për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022

Sfera	Sfera civile						
Lloji i lëndës							
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuar a gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të ndryshme civile dhe ndeshje të kompetencave të ndryshme	6	359	0	0	365	334	31
Gjithsej – lloji i lëndës	6	359	0	0	365	334	31
Lloji i lëndës	Lëndë civile sipas revizionit						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuar a gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Konteste ekonomike - revizion	173	213	1	0	387	222	165
Konteste pune - revizion	63	132	1	0	196	92	104
Konteste civile – revizion	375	437	0	0	812	455	357
Gjithsej – lloji i lëndës	611	782	2	0	1395	769	626
Gjithsej - sfera	617	1141	2	0	1760	1103	657
Sfera	Sfera penale						
Lloji i lëndës							
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të kryera	Përsëri në punë	Të evidentuar a gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të ndryshme penale	9	299	0	0	308	282	26
Mbrojtje e ligjshmërisë sipas lëndëve penale	7	18	0	0	25	24	1
Zbutje e jashtëzakonshme e vendimit	6	13	0	0	19	14	5
Gjithsej – lloji i lëndës	22	330	0	0	352	320	32
Lloji i lëndës	Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur

				a gabimisht			
Shqyrtim i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm krim i organizuar – këshilli prej pesë gjyqtarëve	11	18	0	0	29	23	6
Shqyrtim i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm - këshilli prej pesë gjyqtarëve	85	174	0	0	259	238	21
Gjithsej – lloji i lëndës	96	192	0	0	288	261	27
Lloji i lëndës	Lëndë penale të shkallës së tretë						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuar a gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Ankesa të aktgjytimeve në shkallën e tretë	6	40	0	0	46	36	10
Ankesa të aktvendimeve për paraburgim	0	36	0	0	36	36	0
Gjithsej – lloji i lëndës	6	76	0	0	82	72	10
Gjithsej - sfera	124	598	0	0	722	653	69
Sfera	Gjykim në afatin e arsyeshëm						
Lloji i lëndës	Gjykim në afat të arsyeshëm – të shkallës së dytë						
Lloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuar a gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Gjykim në afat të arsyeshëm - ankesa	43	160	1	0	204	181	23
Gjithsej – lloji i lëndës	43	160	1	0	204	181	23
Lloji i lëndës	Gjykim në afat të arsyeshëm – të shkallës së parë						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuar a gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Gjykim në afat të arsyeshëm - Administrative	86	61	2	0	149	120	29
Gjykim në afat të arsyeshëm - Penale	21	45	0	1	65	47	18
Gjykim në afat të arsyeshëm - Civile	61	85	3	0	149	140	9
Gjithsej në punë – lloji i lëndës	168	191	5	1	363	307	56
Gjithsej - sfera	211	351	6	1	567	488	79
Sfera	Sfera administrative						
Lloji i lëndës							
Lloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuar a gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Mbrojtja e ligjshmërisë në kontestin civil	0	2	0	0	2	2	0

Ankesa kundër vendimeve të Gjykatës Administrative	3	10	0	0	13	12	1
Gjithsej – lloji i lëndës	3	12	0	0	15	14	1
Lloji i lëndës	Ankesa kundër vendimeve të KGJRMV						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuar a gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Ankesa kundër vendimeve të KGJRMV – për zgjedhje	1	4	0	0	5	4	1
Gjithsej – lloji i lëndës	1	4	0	0	5	4	1
Gjithsej - sfera	4	16	0	0	20	18	2
Gjithsej	956	2106	8	1	3069	2262	807

VËLLIMI DHE VENDIMARRJA SIPAS SEKTORËVE

SEKTORI I VEPRAVE PENALE

Gjyqtarët e Sektorit të veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2022 kanë vepruar lëndët juridiko -penale, me pjesëmarrjen në punën e Seancës së përgjithshme dhe seancat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe me disa aktivitete tjera që çojnë në zbatimin më të mirë dhe më efikas të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në përputhshmëri me Kushtetutën, aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, si dhe në aktivitetet jashtë lëndëve dhe në vazhdimësi kontribuon për realizimin më të mirë të rolit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në sigurimin e zbatimit unik të ligjeve nga ana e gjykatave, sidomos kur bëhet fjalë për zbatimin e ligjeve nga sfera e të drejtës penale.

Pasqyra totale e punës sipas lëndëve

Gjatë vitit raportues 2022 janë pranuar 598 lëndë të reja, 124 lëndë kanë mbetur nga muaji dhjetor 2021, ose gjithsej në punë kanë qenë 722 lëndë sipas të gjitha bazave. Gjatë vitit raportues gjyqtarët kanë kryer 653 lëndë, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur të pakryera 69 lëndë nga të gjitha bazat. Sipas të dhënave të theksuara, fluksi i lëndëve është tejkualuar për 90,44%, ndërsa të gjitha 124 lëndët që kanë mbetur janë kryer në vitin 2022, që tregon se Sektori i veprave penale në vitin 2022, është absolutisht efikas në veprimin dhe vendimmarrjen.

Pasqyra e gjithsej lëndëve të kryera dhe të pa kryera sipas bazave të ndryshme, në vitin 2022 është dhënë në tabelën si vijon;

Lloji i lëndës	Kanë mbetur nga muaji XII 2021	Të pranuar në vitin 2022	Gjithsej në punë	Të kryera	Të pakryera
VKZH1	-	36	36	36	-
VKZH2	6	40	46	36	10
KVP1	-	-	-	-	-
KVP2	85	174	259	238	21
Kvp-KOK1-Kvp	-	-	-	-	-
Kvp-KOK2-Kvp	11	18	29	23	6
VUK	6	13	19	14	5
KZZ	7	18	25	24	1
KR	9	299	308	282	26
GJITHSEJ	124	598	722	653	69

69 lëndët që kanë mbetur të pakryera në fund të vitit i nënshtrohen asaj që një pjesë e lëndëve nuk janë kryer. Остатокот од вкупно нерешени 69 предмети на крајот на 2022 година, се должи на тоа што 17 предмети кои биле пратени на мислење во Јавно обвинителство на Република Северна Македонија во тековната 2022 година, а не се вратени во Судот на одлучување до 31.12.2022 година од кои: ВУК-1 предмет, КВП2-8 предмети, КВП-КОК2-4 предмети, ВКЖ2-2 предмети и КР-2 предмети.

Struktura e lëndëve të kryera sipas llojit të veprave penale

Struktura e lëndëve të kryera, sipas llojit të veprave penale për kërkesat për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – KVP2, Kvp.KOK2, e gjithsej 261 lëndëve, është si vijon:

Kreu XIV nga Kodi penal

Vepra penale kundër jetës dhe trupit

49 lëndë për veprë penale – Vrasje nga neni 123;

10 lëndë për vepër penale – Lëndim trupor – neni 130;

8 lëndë për vepër penale – Lëndim i rëndë trupor – neni 131;

1 lëndë për vepër penale – Kërcënimi me mjet të rrezikshëm gjatë rrahjes apo përlëshjes – neni 133.

Kreu XV nga Kodi penal

Vepra penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit

1 lëndë për vepër penale – Rrëmbimi nga neni 141;

3 lëndë për vepër penale – Keqtrajtimi gjatë kryerjes së detyrës nga neni 143;

3 lëndë për vepër penale – Rrezikimi i sigurisë – nga neni 144;

Kreu XIX nga Kodi penal

Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor

7 lëndë për vepër penale – Dhunimi – neni 186;

5 lëndë për vepër penale – Kryerja e aktit seksual me person të paaftë – neni 187;

13 lëndë për vepër penale – Sulmi seksual ndaj të miturit që nuk ka mbushur 14 vjet – neni 188;

2 lëndë për vepër penale – Kryerja e aktit seksual me keqpërdorim të pozitës nga neni 189;

2 lëndë për vepër penale – Ekspozimi i materialit pornografik të miturit nga neni 193;

Kreu XXII nga Kodi penal

Vepra penale kundër mjedisit ajror dhe natyrës

1 lëndë për vepër penale – Shkretimi i pyllit nga neni 226;

1 lëndë për vepër penale – Gjuetia e paligjshme nga neni 228

Kreu XXIII nga Kodi penal

Vepra penale kundër pronës

7 lëndë për vepër penale – Vjedhja – neni 235;

1 lëndë për vepër penale – Vjedhja e energjisë elektrike, energjisë termike ose gazit natyror nga neni 235-a;

19 lëndë për vepër penale – Vjedhja e rëndë nga neni 236;

32 lëndë për vepër penale – Grabitja nga neni 237;

2 lëndë për vepër penale – Vjedhja grabitqare nga neni 238;

1 lëndë për vepër penale – Dëmtimi i sendeve të huaja nga neni 243;

2 lëndë për vepër penale – Ndërtimi i paligjshëm nga neni 244-a;

24 lëndë për vepër penale – Mashtrimi nga neni 247;

1 lëndë për vepër penale – Keqpërdorimi i besimit nga neni 252;

1 lëndë për vepër penale – Dëmtimi apo favorizimi i kreditorëve nga neni 257;

4 lëndë për vepër penale – Shtrëngimi (detyrimi, shantazhi) nga neni 258;

1 lëndë për vepër penale – Fshehja (të fshehurit, mbulimi) nga neni 261;

Kreu XXIV nga Kodi penal

Vepra penale kundër trashëgimisë kulturore dhe rariteteve natyrore

1 lëndë për vepër penale – Dëmtimi apo shkatërrimi i të mirave nën mbrojtje të përkohshme apo trashëgimisë kulturore apo rariteteve natyrore nga neni 264;

Kreu XXV nga Kodi penal

Vepra penale kundër financave publike, qarkullimit të pagesave dhe ekonomisë

2 lëndë për vepër penale – Larja e parave dhe dobia tjetër e kundërligjshme e pasurisë nga neni 273;

3 lëndë për vepër penale – Kontrabanda nga neni 278-;

3 lëndë për vepër penale – Fshehja e tatimit nga neni 279;

Kreu XXVI nga Kodi penal

Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës

2 lëndë për vepër penale – Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 288;

3 lëndë për vepër penale – Vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme nga neni 292

Kreu XXVII nga Kodi penal

Vepra penale kundër sigurisë në komunikacionin publik

2 lëndë për vepër penale – Rrezikimi i sigurisë në trafik nga neni 297;

30 lëndë për vepër penale – Vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik nga neni 300;

Kreu XXVIII nga Kodi penal

Vepra penale kundër shtetit

1 lëndë për vepër penale – Ndëshkimi për përgatitje nga neni 326;

Kreu XXX nga Kodi penal

Vepra penale kundër detyrës zyrtare

19 lëndë për vepër penale – Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar nga neni 353;

74 lëndë për vepër penale – Të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës nga neni 353-c;

1 lëndë për vepër penale – Dhënia e ryshfetit nga neni 358;

1 lëndë për vepër penale Ndërmjetësimi i kundërligjshëm nga neni 359;

Kreu XXXI nga Kodi penal

Vepra penale kundër drejtësisë

1 lëndë për vepër penale – Dhënia e dëshmisë së rrejshme nga neni 367;

1 lëndë për vepër penale – Të ndikuarit e paligjshëm ndaj dëshmitarëve nga neni 368-a;

1 lëndë për vepër penale – Moszbatimi i vendimit gjyqësor nga neni 377;

Kreu XXXII nga Kodi penal

Vepra penale kundër qarkullimit juridik

3 lëndë për vepër penale - Falsifikimi i dokumenteve nga neni 378

Kreu XXXIII nga Kodi penal

Vepra penale kundër rendit publik

1 lëndë për vepër penale - Pengimi i personit në kryerjen e veprimit zyrtar nga neni 382;

2 lëndë për vepër penale – Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së punëve të sigurimit nga neni 383;

3 lëndë për vepër penale – Pjesëmarrja në një turmë që do të kryejë vepër penale nga neni 385;

7 lëndë për vepër penale – Dhuna nga neni 386;

3 lëndë për vepër penale – Bashkimi kriminal nga neni 394;

6 lëndë për vepër penale – Organizata terroriste nga neni 394-a;

16 lëndë për vepër penale – Përpunimi, mbajtja dhe tregtia e palejuar a armës apo materieve shpërthyes nga neni 396;

Kreu XXXIV nga Kodi penal

Vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës kombëtare

6 lëndë për vepër penale – Kontrabandë me emigrantë nga neni 418-b;

2 lëndë për vepër penale – Organizimi i grupit dhe nxitje për kryerje të veprave tregti me njerëz, tregti me person të mitur dhe kontrabandë me emigrantë nga neni 418-c;

2 lëndë për vepër penale – Tregtia me person të mitur nga neni 418-ç;

Struktura e lëndëve të kryera sipas llojit për kundërvajtje, të evidentuara në Regjistrin – KR është si vijon:

41 lëndë -kundërvajtje nga LSKR;

108 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për rendin dhe qetësinë publike;

2 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për pyjet;

31 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për automjetet;

1 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për gjueti;

1 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për parandalimin e larjes me para dhe financimin e terrorizmit;

5 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për kundërvajtje për rendin dhe qetësinë publike;

1 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës;

2 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse – rrezikimi i vendit

2 lëndë – kundërvajtje nga Mbrojtja nga pirja e duhanit;

1 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për tatim;

1 lëndë – kundërvajtje kundër sigurisë publike me pasoja dëmi;

Nga gjithsej numri i 261 lëndëve për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm sipas numrit të lëndëve dhe personave të dënuar, gjendja është si vijon:

	Me 1 person	Me 2 persona	Me 3 persona	Me 4 persona	Me 6 persona	Me 25 persona	GJITHSEJ
KVP1	-	-	-	-	-	-	-
KVP2	209	22	5	2	-	-	238
KVP-KOK1	-	-	-	-	-	-	-
KVP-KOK2	15	3	3	1	-	1	23
Gjithsej	224	25	8	3	-	1	261

Nga gjithsej numri i 261 lëndëve për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – KVP1, KVP2, Kvp.KOK1 dhe Kvp.KOK2 **sipas gjykatave të apelit** dhe sipas vendimit të këshillit, gjendja është shfaqur në tabelën si vijon:

Gjykata	KVP1, KVP2		KVP-KOK1		KVP-KOK2	
	Të kryera	Të pakryera	Të kryera	Të pakryera	Të kryera	Të pakryera
Gjykata e Apelit Shkup	115	3	-	-	23	6
Gjykata e Apelit Manastir	54	4	-	-	-	-
Gjykata e Apelit Shtip	31	9	-	-	-	-
Gjykata e Apelit Gostivar	38	5	-	-	-	-
GJITHSEJ	238	21	-	-	23	6
					29	

Tregues për kërkesa të refuzuara, të aprovuara, të ndryshuara dhe të hedhura poshtë sipas të gjitha bazave:

Lloji i lëndës	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të hedhura poshtë	Të kryera	Të pakryera
VKZH1	32	3	-	1	36	-
VKZH2	19	6	1	10	36	10
KVP1	-	-	-	-	-	-
KVP2	161	24	1	52	238	21
VUK	14	-	-	-	14	5
KZZ	13	11	-	-	24	1
KR	2	1	279	-	282	26
Kvp.KOK1	-	-	-	-	-	-
Kvp.KOK2	16	1	-	6	23	6
GJITHSEJ	257	46	281	69	653	69

Gjendja e lëndëve sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë-KZZ, të parashtruara nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që kanë qenë në procedurë në Sektorin e veprave penale dhe që kanë të bëjnë me gjykatat themelore dhe të apelit.

Nga të dhënat e marra nga sistemi - AKMIS, prej gjithsej 24 kërkesave të kryera, 11 janë të refuzuara si të pabaza. nga 8 lëndët e aprovuara: në 3 lëndë është abroguar edhe aktgjykimi i shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, në 5 lëndë është abroguar vetëm aktgjykimi i shkallës së dytë dhe në 5 lëndë është konstatuar shkelja e KP-së, ndërsa vetëm 1 lëndë ka mbetur e pakryer.

Në rajonet e apelit gjendja e lëndëve të kryera dhe të pakryera është si vijon: 14 lëndë nga Gjykata e Apelit Shkup, 9 lëndë janë të kryera dhe 3 të pakryera, 2 lëndë nga Gjykata e Apelit Manastir, nga të cilat 3 janë të kryera dhe 1 të pakryer, 6 lëndë nga Gjykata e Apelit Shtip nga të cilat 6 janë të kryera dhe 2 të pakryera dhe 2 lëndë nga Gjykata e Apelit Gostivar nga të cilat 2 lëndë janë të kryera dhe 1 lëndë e pakryer. Me një person të dënuar ka pasur 16 lëndë, me dy persona 3 lëndë dhe me 5 persona 1 lëndë, ose gjithsej 20 persona të dënuar.

Gjendja e lëndëve në procedurën e shkallës së tretë – **VKZH1** për ankesa të aktvendimeve për paraburgim dhe për ankesa të aktgjykimeve të Gjykatave të Apelit është shfaqur në tabelat në vijim:

VKZH1- ankesa të aktvendimeve për paraburgim

Numri i lëndëve të pranuar në vitin 2022	Kanë mbetur nga muaji 12 të v. 2021.	Lëndë të reja të pranuar	Gjithsej në punë	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuar	Në tjetër mënyrë	Të kryera	Të pakryera
36	-	36	36	1	32	3	-	36	-
Gjithsej 36	-	36	36	1	32	3	-	36	-

VKZH2 – ankesa të aktgjykimeve në shkallën e tretë

Numri i lëndëve të pranuar në vitin 2022	Kanë mbetur nga muaji 12 i v.2021	Lëndë të reja të pranuar	Gjithsej në punë	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuar	Në tjetër mënyrë	Të kryera	Të pakryera
40	6	40	46	10	19	6	1	36	10
Gjithsej	6	40	46	10	19	6	1	36	10

Sipas ankesave për paraburgim – VKZH1 të pakryera nga viti i kaluar nuk ka, në vitin 2022 janë pranuar 36 lëndë, ose gjithsej në punë kanë qenë 36 lëndë nga të cilat në 32 lëndë ankesa është refuzuar si e pabazë, në 3 lëndë ankesa është aprovuar, ndërsa në 1 lëndë ankesa është hedhur poshtë.

Sipas ankesave të aktgjykimeve në shkallën e tretë – VKZH2 të pakryera nga viti i kaluar janë 6 lëndë, në vitin 2022 janë pranuar 40 lëndë, ose gjithsej në punë kanë qenë 46 lëndë nga të cilat 19 lëndë janë të refuzuara, 6 lëndë janë të aprovuara, 10 lëndë janë të hedhura poshtë, 1 lëndë është kryer në tjetër mënyrë, gjithsej të kryera janë 36 lëndë, ndërsa kanë mbetur 10 lëndë të pakryera.

Gjendja e lëndëve për zbutjen e jashtëzakonshme të vendimit – **VUK** është si vijon:

Nga viti 2021 6 lëndë kanë mbetur të pakryera, në vitin 2022 janë pranuar 13 lëndë të reja, gjithsej në punë kanë qenë 19 lëndë nga të cilat 14 lëndë janë të kryera, ndërsa 5 lëndë kanë mbetur të pakryera. Sipas llojit të vendimit: 14 lëndë janë të refuzuara.

Gjendja e lëndëve të evidentuara si **KR**, ku Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, miraton vendime për përcaktimin e ndeshjes së kompetencave mbartjen e kompetencës vendore dhe reale, me kërkesa të parashtuara, nga paditësi subsidijar, me kërkesa të parashtuara për ekstradim, me kërkesa të parashtuara për parashkrim në procedurën për kundërvajtje, me kërkesa të parashtuara për kthimin në procedurën e mëparshme dhe të tjera, është si vijon:

Nga viti 2021 kanë mbetur 9 lëndë të pakryera, në vitin 2022 janë pranuar 299 lëndë të reja gjithsej në punë kanë qenë 308 lëndë, nga të cilat 282 lëndë janë të kryera, ndërsa 26 lëndë kanë mbetur të pakryera. Sipas llojit të vendimit: 2 lëndë janë të refuzuara, 1 lëndë është e aprovuar dhe 279 lëndë në tjetër mënyrë, ndërsa të hedhura poshtë nuk ka.

Kohëzgjatja e procedurës së lëndëve sipas bazave

Kohëzgjatja e procedurës së lëndëve në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga pranimi i lëndëve në Sektorin e veprave penale deri në kryerjen dhe në dërgimin e lëndëve.

Në vitin 2022 nga të dhënat e siguruara nga sistemi AKMIS, me numra të ndara të lëndëve nuk ka qenë e mundur të vepohet për shkak të pengesave administrative që është duhur të tejkalohen (sigurimi i shkresave, mungesa e shkresave në origjinal, rregullimi për dorëzimin e aktgjykimit të shkallës së dytë të akuzuarit, dorëzimi i dëshmimeve, dëshmi të dorëzuara në fotokopje, dorëzimi në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të ngjashme).

Disa lëndë në gjykatë kanë arritur edhe me shkresa të pakompletuara, dhe është duhur që administrativisht t'ju kthehen gjykatave, ose Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, apo janë bërë përpjekje që atë ta bëjë gjyqtari, të cilit i është shpërndarë lënda me përskrim, me organin nga i cili është pranuar lënda.

PUNA E SEKTORIT TË VEPRAVE PENALE

Spektori i veprave penale gjatë vitit 2022 në seancat e mbajtura, ka vepruar mbi materialet e siguruara, çështjet, kërkesat dhe iniciativat e parashtuara.

Më 31.01.2022 është mbajtur seancë e Sektorit të veprave penale, në të cilën është nxjerrë ky **konkluzion**:

Principi i gjykimit të drejtë nënkupton të drejtën e mbajtjes së diskutimit kryesor dhe respektimin e principit të kontradiktës së procedurës, të cilat duhet të zbatohen edhe në procedurën për marrjen e sendeve, me obligim që gjykata parashtresat nga njëra anë ti dërgojë për këqyrje dhe për përgjigje të palës së kundërt, duke përfshirë edhe ekspertizat, në mënyrë që do të respektohet principi i barabarësisë së mjeteve të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa sipas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*Transkop AD Manastir kundër Maqedonisë së Veriut*), nr.48057/12, § § 29-35, 1 prill 2021).

Më 31.01.2022 u mbajtur seancë e Sektorit të veprave penale, ku u nxor **konkluzioni** në vijim:

Çdoherë kur një dëshmitarë që është propozuar të merret në pyetje në seancën kryesore në gjykatë, ndërsa i njëjti nuk mund të sigurohet për shkak të ekzistimit të ndonjë arsyeje të theksuar në nenin 388 paragrafi (5) të LPP, procesverbalet për deklaratat e dhëna para Prokurorit Publik, mundet që me vendim të gjykatës të nxirren si provë me lexim, ose me reproduktim. Para se të vendoset nëse do të nxirret si provë deklarata e dhënë në hetim duhet së pari të shqyrtohet: nëse deklarata e atij dëshmitari

paraqet bazën e vetme apo vendimtare për dënimin e të akuzuarit dhe nëse ekzistojnë mjaft faktorë të kundërpeshës që të mund të kompensohet pozita e tillë e mbrojtjes si rezultat i pranimit të dëshmisë nga dëshmitari që nuk ka qenë i pyetur në seancën dëgjimore.

Gjyqtarët duhet të kenë kujdes për të drejtën në përgjithësi të procedurës penale. Pas kësaj, përshtatja me kërkesat për gjykim të drejtë duhet të shqyrtohet në secilin rast veçmas, duke marrë parasysh zhvillimin e procedurës si tërësi, e jo në bazë të vlerësimit të izoluar në një aspekt apo ngjarje të veçantë.

Principet relevante në lidhje me të dhënat ankimore për shkeljen e të drejtave të mbrojtjes për shkak dëshmime të siguruara nga një dëshmitar në mungesë, të prezantuara në rastet e Trampevski, Boshkoski dhe Janeski kundër RMV, do të zbatohen në të gjitha rastet lidhur me dëshmitarët në mungesë dhe dëshmitarët me identitet të fshehur (dëshmitarët anonim).

Mbajtja e seancave publike gjyqësore (seancave kryesore) paraqet princip themelor të gjykimit të drejtë. Me zbatimin transparent të drejtësisë, publiku kontribuon në përmbushjen e qëllimit të gjykimit të drejtë, një nga principet themelore të çdo shoqërie demokratike, në kuadër të rëndësisë së Konventës dhe ligjeve nacionale. Megjithatë, kërkesa për mbajtjen e seancës kryesore publike i nënshtrohet përjashtimeve, sidomos kur ajo është në interes të moralit, rendit publik apo sigurisë nacionale në një shoqëri demokratike, më tej, aty ku atë e kërkojnë interesat e personave të mitur apo mbrojtja e jetës private të palëve, apo deri në atë shkallë që është e domosdoshme sipas mendimit të gjykatës në rrethana të posaçme ku publiku do ti dëmtonte interesave të drejtësisë. Krahas kësaj, mund të jetë e domosdoshme që të kufizohet karakteri i hapur dhe publik i procedurave me qëllim, për shembull, që të mbrohet siguria apo privatësia e dëshmitarëve apo të promovohet këmbimi i lirë i mendimeve dhe informacioneve gjatë zbatimit të së drejtës.

Në të gjitha rastet, para se të përjashtohet publiku në procedurën penale, gjyqtari doemos duhet të konstatojë konkretisht dhe të sqarojë shkaqet për atë se përjashtimi është i domosdoshëm, për tu mbrojtur interesi publik, në mënyrë që duhet të kufizojë sekretin deri në atë shkallë që është e domosdoshme për ruajtjen e atij interesi. Gjatë konstatimit nëse ai vendim in kamera është në pajtueshmëri me të drejtën e seancës kryesore publike si element përbërës është i balancuar me domosdoshmërinë për transparencë, nëse mbrojtjes i janë prezantuar të gjitha dëshmitë dhe nëse procedura si tërësi ka qenë e drejtë.

Më 31.01.2022 është mbajtur seancë e Sektorit të veprave penale, në të cilën është nxjerrë ky **konkluzion:**

Kur pas seancë kryesore dhe fjalëve të dhëna të fundit të palëve, në fazën e këshillimit dhe votimit, gjykata ka bërë rikualifikimin e veprës penale, gjykata duke e marrë parasysh fazën në të cilën gjendet lënda nuk ka mundësi ligjore që të thërritet i akuzuari që të deklarohet për fajin.

Më 16.02.2022 u mbajt seancë e Sektorit të veprave penale, në të cilën është miratuar **mendimi juridik:**

Dita kur i akuzuari do të hyjë në Institucionin ndëshkues penal për vuajtjen e dënimit me burg, konsiderohet për ditën kur rrjedh afati i parashkrimit të përmbartimit të dënimit me burg.

Paraburgimi i ekstradimit është masë për sigurimin e pranisë së të akuzuarit dhe koha e kaluar në paraburgimin e ekstradimit, llogaritet në dënimin e vuajtur me burg dhe nuk mund të konsiderohet për ditën kur fillon kryerja e dënimit me burg.

Më 07.12.2022 u mbajt seancë e Sektorit të veprave penale, në të cilën është nxjerrë ky **konkluzion:**

Kur vendos Gjykata Supreme në procesverbalet për lëndët KZZ duhet të ketë titull ai procesverbal, përkatësisht procesverbal për seancën e mbajtur, apo procesverbal për këshillim dhe votim.

Sektori i veprave penale gjatë vitit 2022 miratoi sentenca për lëndët në vijim: Kzz.nr.9/2021, Kzz.nr.10/2021, Kr.nr.204/2021 dhe Vkzh1.nr.7/2022.

SEKTORI I VEPRAVE CIVILE

Sipas Ligjit për gjykatat, Rregullores gjyqësore, Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programit të punës së Sektorit për vitin 2022 dhe Orarit të punës së Gjykatës për vitin 2022, Sektori i veprave civile gjatë vitit 2022 ka punuar për lëndët nga sfera e kontesteve civile.

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2022, obligimet punuese i ka kryer sipas kompetencave të caktuara në rregullat ligjore sipas materies në fjalë, me Programin e punës të miratuar nga ana e Sektorit të veprave civile ndërsa përveç kësaj i ka realizuar edhe obligimet e parashtruara nga gjykata. Në Sektorin e veprave civile është vendosur për mjete të jashtëzakonshme juridike të parashtruara kundër vendimeve gjyqësore të plotfuqishme, si dhe për lëndë për konflikt të kompetencave, përcaktimin e një gjykate tjetër kompetente reale, vazhdimin e afatit për parashtrimin e padisë për kontestimin e atësisë. Krahas punës së lëndëve konkrete, gjyqtarët morën pjesë në punën e seancave të Sektorit të veprave civile, ku u shqyrtuan çështje aktuale, u miratuan disa mendime juridike dhe u nxorën konkluzione për çështje të ndryshme kontestuese juridike për zbatimin e rregullave ligjore, si dhe u miratua 1 sentencë. Po ashtu, gjyqtarët në mënyrë aktive morën pjesë në punën e Seancës së përgjithshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në Seanca të gjyqtarëve të Gjykatës.

Krahas kësaj, gjyqtarët nga Sektori i veprave civile me Orarin e punës së Kryetarit dhe gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, kanë marrë pjesë edhe në sektorët tjerë të gjykatës. Në fakt, disa gjyqtarë morën pjesë në vendimmarrjen mbi kërkesat për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afatin e arsyeshem dhe në këshillin e shkallës së dytë që vendos mbi ankesat kundër aktvendimeve të këshillit nga tre gjyqtarët mbi kërkesat për gjykim në afatin e arsyeshem; në punën e Sektorit dhe këshillit të veprave penale; në punën e Këshillit të specializuar për vendimmarrjen e ankesave të kandidatit që nuk është zgjedhur për gjyqtarë; në Këshillin e specializuar për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Gjykatës Administrative nga neni 62 të Ligjit për konteste administrative, me propozim për mbrojtjen për shkak të veprimit joligjor; në punën e Sektorit të praktikës gjyqësore, së bashku me këshilltarët gjyqësorë.

Struktura e lëndëve

Nga treguesit numëror për vitin 2022 në Sektorin e veprave civile ka pasur gjithsej **1.760** lëndë në punë, janë pranuar **1141** lëndë të reja, janë kryer gjithsej **1103** lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera **657** lëndë, nga të cilat 109 janë lëndë të pakryera nga viti 2021, 547 lëndë të pakryera nga viti 2022.

Në vitin 2022 në Sektorin e veprave civile fluksi i lëndëve të reja nuk është tejkaluar, përkatësisht në vitin 2022 janë pranuar gjithsej **1141** lëndë, ndërsa janë kryer gjithsej **1103** lëndë, në mënyrë që fluksi i lëndëve nuk është tejkaluar për **38** lëndë. Në vitin 2022 numri i lëndëve të pakryera është rritur për **40** lëndë, përkatësisht prej 617 lëndëve që kanë mbetur në fund të vitit 2021, në vitin 2022 në fund të vitit kanë mbetur 657 lëndë të pakryera.

Sfera	Sfera civile						
Lloji i lëndës							
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të ndryshme civile dhe ndeshje të kompetencave të ndryshme	6	359	0	0	365	334	31
Gjithsej – lloji i lëndës	6	359	0	0	365	334	31
Lloji i lëndës	Lëndë civile sipas revizionit						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Konteste tregtare – revizion	173	213	1	0	387	222	165
Konteste pune – revizion	63	132	1	0	196	92	104
Konteste civile – revizion	375	437	0	0	812	455	357
Gjithsej – lloji i lëndës	611	782	2	0	1395	769	626
Gjithsej - sfera	617	1141	2	0	1760	1103	657

Struktura e 1103 lëndëve të kryera është si vijon: nga Regjistri Rev1 – janë kryer 222 lëndë; nga Regjistri Rev2 – janë kryer 455 lëndë; nga Regjistri Rev3 – janë kryer 92 lëndë, nga Regjistri R – janë kryer 334 lëndë.

Struktura e 657 lëndëve të pakryera është si vijon: 1 lëndë ka mbetur e pakryer nga viti 2019 nga Regjistri Rev2, për shkak se disa herë është kthyer administrativ në gjykatën e shkallës së parë, ndërsa është kryer në fillim të janarit të vitit 2023. Nga viti 2021 kanë mbetur 32 lëndë të pakryera nga Regjistri Rev1, nga Regjistri Rev2 kanë mbetur 67 lëndë të pakryera dhe nga Regjistri Rev3 kanë mbetur 10 lëndë të pakryera. 547 lëndët që kanë mbetur të pakryera janë nga viti 2022 edhe atë nga Regjistri Rev1 – 133 lëndë të pakryera, nga Regjistri Rev2 – 289 lëndë të pakryera dhe nga Regjistri Rev3 kanë mbetur 94 lëndë të pakryera, nga Regjistri R kanë mbetur 31 lëndë të pakryera.

Lëndë të pa kryera sipas vitit të pranimit	Të pranuar në vitin 2019	Të pranuar në vitin 2020	Të pranuar në vitin 2021	Të pranuar në vitin 2022	Gjithsej
Regjistri i lëndëve civile sipas revizionit	1	0	67	289	375
Regjistri i kontesteve tregtare sipas revizionit	0	0	32	133	165
Regjistri i kontesteve të punës sipas revizionit	0	0	10	94	104
Regjistri i lëndëve të ndryshme civile	0	0	0	31	31
Gjithsej	1	0	109	547	657

Mënyra e kryerjes së lëndëve

Procedura e revizionit si mjet i jashtëzakonshëm juridik, shfrytëzohet nga palët për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre. Nga gjithsej numri i **1.760** lëndëve që kanë qenë në punë në vitin 2022 sipas revizionit kanë qenë **1.395** lëndë, nga të cilat nga Regjistri **Rev1 – 387** lëndë, nga Regjistri **Rev2 – 812** lëndë dhe nga Regjistri **Rev3 – 196** lëndë, përkatësisht **55,1%**.

Lloji i lëndës	Lëndë civile sipas revizionit						
	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Konteste tregtare – revizion	173	213	1	0	387	222	165
Konteste pune – revizion	63	132	1	0	196	92	104
Konteste civile – revizion	375	437	0	0	812	455	357
Gjithsej – lloji i lëndës	611	782	2	0	1395	769	626

Nga numri i 769 lëndëve, përmbajtja e vendimeve të revizionit duket kështu: të refuzuara janë 448 përkatësisht 58,2%, të ndryshuara 42 përkatësisht 5,5%, të abroguara 97 përkatësisht 12,7%, të hedhura poshtë 179 përkatësisht 23,3%, të kryera në mënyrë tjetër 2 përkatësisht 0,3%.

Gjykata	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të ndryshuara	Të abroguara	Të kryera në mënyrë tjetër	Gjithsej
Shkup	123	307	25	66	2	523
Manastir	26	71	8	10	/	115
Shtip	12	27	4	8	/	51
Gostivar	15	43	5	13	/	76
Administrative	3	1	/	/	/	3
Gjithsej	179	448	42	97	2	769

Gjendja në gjykatat e apelit lidhur me **revizionet e refuzuara** në vitin 2022, duket kështu:

Gjykata	Gjithsej revizione të kryera	Revizione të refuzuara	Përqindja e revizioneve të refuzuara
Shkup	523	307	58,7
Manastir	115	71	61,7
Shtip	51	27	53
Gostivar	76	43	56,5
Administrative	4	1	25
Gjithsej	769	448	58,2

Gjendja në gjykatat e apelit lidhur me revizionet e aprovuara me **vendime të ndryshuara** në vitin 2022, është si vijon:

Gjykata	Gjithsej revizione të kryera	Vendime të ndryshuara	Përqindja e revizioneve të ndryshuara
Shkup	523	25	4,8
Manastir	115	8	7
Shtip	51	4	7,8
Gostivar	76	5	6,6
Administrative	4	0	0
Gjithsej	769	42	5,5

Gjendja e gjykatave të apelit lidhur me revizionet e aprovuara me **vendime të abroguara** në vitin 2022, duket kështu:

Gjykata	Gjithsej revizione të kryera	Vendime të abroguara	Përqindja e vendimeve të abroguara
Shkup	523	66	12,6
Manastir	115	10	8,7
Shtip	51	8	15,7
Gostivar	76	13	17,1
Administrative	4	0	0
Gjithsej	769	97	12,7

Gjendja e gjykatave të apelit lidhur me **revizionet e hedhura poshtë** në vitin 2022, është si vijon:

Gjykata	Gjithsej revizione të kryera	Revizione të hedhura poshtë	Përqindja e revizioneve të hedhura poshtë
Shkup	523	123	23,5
Manastir	115	26	22,6
Shtip	51	12	23,5
Gostivar	76	15	19,8
Administrative	4	3	75
Gjithsej	769	179	23,3

Gjendja e gjykatave të apelit lidhur me **revizionet e kryera në mënyrë tjetër** në vitin 2022, është si vijon:

Gjykata	Gjithsej revizione të kryera	Të kryera në mënyrë tjetër	Përqindja e revizioneve të hedhura poshtë
Shkup	523	2	0,4
Manastir	115	/	/
Shtip	51	/	/
Gostivar	76	/	/
Administrative	4	/	/
Gjithsej	769	2	0,3

Procedura tjera

Sektori i veprave civile përveç mjeteve të jashtëzakonshme juridike, ka vendosur edhe për lëndë tjera nga kompetenca e tij. Ato janë lëndë për konflikt të kompetencave, përcaktim të një gjykate tjetër kompetente reale, vazhdimi i afatit për parashtrimin e padisë për kontestimin e atësisë, nga të cilat në punë kanë qenë gjithsej 365 lëndë dhe nga ato 334 lëndë janë të kryera, ose 91,5 %, ndërsa kanë mbetur të pakryera 31 ose 8,5%.

Nënlloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Lëndë të ndryshme civile dhe konflikt të ndryshme kompetencash	6	359	0	0	365	334	31
Gjithsej – lloji i lëndës	6	359	0	0	365	334	31

Struktura e lëndëve sipas bazave

Dukshëm nga bazat juridike të revizioneve, për të cilat është vendosur në Sektorin e veprave civile gjatë vitit 2022, mund të konstatohet ndryshueshmëri. Të shumta janë lëndët me bazë për kompensim të dëmit – **221** lëndë ose 28,7%, pastaj me bazë borxhi - **189** lëndë ose 24,6%, për pronësi dhe zotërim - **125** lëndë ose 16,3%; konteste pune - **83** lëndë ose 10,8%; për falimentim - **42** lëndë ose

5,4%, shfuqizimi dhe ndërprerja e marrëveshjes - **39** lëndë ose 5,1%; për asistencë - **35** lëndë ose 4,6%, për arritje pa bazë - **30** lëndë ose 3,9%, dhe të drejtat e autorit dhe pronësia industriale - **5** lëndë ose 0,6%.

Baza	2022
Asistenca	35
Kompensim i dëmit	221
Arritja pa bazë	30
Shfuqizimi dhe ndërprerja e marrëveshjes	39
Borxhi	189
Pronësia dhe zotërimi	125
Konteste pune	83
Falimentim	42
Të drejtat e autorit	5
Gjithsej	769

Kohëzgjatja e procedurës

Në vitin 2022 nga gjithsej 1103 lëndët e kryera, kohëzgjatja e procedurës me mbi tre vjet ka qenë në 1 lëndë; nga 1 deri në 3 vjet ka qenë në 202 lëndë; nga 8 muaj deri në 1 vjet në 208 lëndë; nga 6 deri në 8 muaj në 40 lëndë; nga 3 deri në 6 muaj ka pasur në 153 lëndë; nga 2 deri në 3 muaj në 126 lëndë, nga 1 deri në 2 muaj në 141 lëndë, deri në 1muaj procedura ka zgjatur në 232 lëndë.

Zgjatja e procedurës	Të kryera	Deri në muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 2 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 6 muaj	Nga 6 deri në 8 muaj	Nga 8 deri në 1 vjet	Nga 1 deri në 3 vjet	Mbi 3 vjet
Regjistri i lëndëve civile të revizionit	455	20	42	41	71	20	133	127	1
Regjistri i kontesteve tregtare të revizionit	92	3	6	13	18	8	23	21	0
Regjistri i lëndëve të ndryshme civile	334	204	62	52	15	1	0	0	0
Regjistri i kontesteve të punës të revizionit	222	5	31	20	49	11	52	54	0
Gjithsej	1103	232	141	126	153	40	208	202	1

Seanca e sektorit

Në vitin 2022 Sektori i veprave civile, ka mbajtur 7 seanca. Në këto seanca është diskutuar për çështje dhe probleme të ndryshme juridike të parashtruara nga gjykatat themelore dhe të apelit dhe nga parashtrues të tjerë, për të cilat janë miratuar 10 mendime juridike dhe një plotësim i mendimit juridik të cilat janë të publikuara në ueb faqen dhe 1 sentencë e miratuar e publikuar. Në Sektorin e veprave civile është vepruar mbi 84 lëndë të ndryshme civile me shenjë Gr për çështje të parashtruara juridike.

SEKTORI PËR GJYKIM NË AFAT TË ARSYESHËM

Sipas Ligjit për gjykata, Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Orarit të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore për vitin 2022, gjyqtarët nga Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm gjatë vitit 2022 kanë vepruar mbi lëndët e formuara për kërkesat e parashtruara për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe ankesat kundër aktvendimeve të këshillave prej tre gjyqtarëve për kërkesat për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Krahas punës për lëndët konkrete nga Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm dhe të seancave të Sektorit, ku u shqyrtuan çështje aktuale dhe konkluzione të nxjerra mbi çështje juridike me kuptim për veprimin e këshillave dhe unifikimin e praktikës së Gjykatës Supreme me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjyqtarët morën pjesë në punën e lëndëve në Sektorin penal dhe atë civil si dhe në Sektorin e praktikës gjyqësore. Gjithashtu, gjyqtarët kanë marrë pjesë në punën e Seancave të përgjithshme dhe seancat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, si dhe në aktivitete të tjera të orientuara kah zbatimin më efikas të Kushtetutës, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare me Kushtetutën, aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe aktivitete jolëndore të orientuara drejt përmirësimit të rolit të Gjykatës Supreme.

Pasqyra totale e punës së lëndëve

Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm, gjatë vitit raportues 2022, në punë ka pasur 567 lëndë. Numrin total të lëndëve në Sektorin e përbëjnë 351 lëndët e reja të pranuar, 211 lëndët që kanë mbetur të pakryera nga periudha raportuese e kaluar, përderisa 6 lëndë kanë qenë përsëri në punë, ndërsa 1 lëndë ka qenë e evidentuar gabimisht. Në vitin 2022, në Sektorin janë kryer 488 lëndë në të dyja shkallët e vendosjes, ndërsa 79 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Në këshillat e shkallës së parë në punë ka pasur 363 lëndë, nga të cilat 191 lëndë të reja të pranuar, 168 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga periudha raportuese e kaluar, 5 lëndë përsëri në punë dhe 1 lëndë e evidentuar gabimisht. Këshillat e shkallës së parë, kanë kryer gjithsej 307 lëndë, ndërsa 56 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Këshilli i shkallës së dytë në punë ka pasur 204 lëndë. Numrin total të lëndëve e përbëjnë 160 lëndë të reja të pranuar, 43 lëndë që kanë mbetur të pakryera nga periudha raportuese e kaluar dhe 1 lëndë që ka qenë përsëri në punë. Në fund të periudhës raportuese, këshilli ankimor i shkallës së dytë ka kryer 181 lëndë, ndërsa 23 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut – raporti për periudhën. 1.2022 – 12.2022

Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm

Sfera	Gjykim në afat të arsyeshëm						
Lloji i lëndës	Gjykim në afat të arsyeshëm – të shkallës së dytë						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Gjykim në afat të arsyeshëm - ankesa	43	160	1	0	204	181	23
Gjithsej - lloji i lëndës	43	160	1	0	204	181	23
Lloji i lëndës	Gjykim në afat të arsyeshëm - të shkallës së parë						
Nënloji i lëndës	Të pakryera	Të reja të pranuar	Përsëri në punë	Të evidentuara gabimisht	Gjithsej në punë	Të kryera	Kanë mbetur
Gjykim në afat të arsyeshëm – Administrative	86	61	2	0	149	120	29
Gjykim në afat të arsyeshëm - Penale	21	45	0	1	65	47	18
Gjykim në afat të arsyeshëm - Civile	61	85	3	0	149	140	9
Gjithsej – lloji i lëndës	177	361	10	0	548	392	156
Gjithsej – sfera	211	351	6	1	567	488	79

Tabela e shfaqur e numrit të lëndëve në Sektorin për vitin 2022

Sipas mënyrës së vendimmarrjes së lëndëve, nga **488** lëndët e kryera në nivel të Sektorit, - në **273** lëndë – kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm refuzohet si e pabazë, në **169** lëndë – kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim të drejtë është aprovuar, ndërsa në **46** lëndë – kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm është hedhur poshtë.

Mënyra e vendimmarrjes – afat të arsyeshëm 2022

Tituj	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të reja të pranuar	Të pakryera në fund të periudhës	Të kryera	Të pakryera nga periudha e kaluar
Regjistri për të drejtën e gjyqimit në afat të arsyeshëm - administrative	19	60	41		63	29	120	86
Regjistri për të drejtën e gjyqimit në afat të arsyeshëm - ankesa	3	144	34		161	23	181	43
Regjistri për të drejtën e gjyqimit në afat të arsyeshëm - penale	6	20	21		44	18	47	21
Regjistri për të drejtën e gjyqimit në afat të arsyeshëm - civile	18	49	73		88	9	140	61
GJITHSEJ	46	273	169		356	79	488	211

Pasqyra totale e punës së lëndëve të këshillave të shkallës së parë

Gjatë vitit **2022**, këshillat e shkallës së parë në punë kanë pasur **363** lëndë apo **64 %** të numrit të përgjithshëm të **567** lëndëve të Sektorit.

Numrin e **363** lëndëve në punë të këshillave të shkallës së parë e përbëjnë **195** apo **54%** lëndë të reja të pranuar dhe **168** apo **46%** lëndë që kanë mbetur të pakryera nga periudha e kaluar raportuese.

Këshillat e shkallës së parë, kanë kryer gjithsej **307** lëndë apo **85%**, përderisa **56** lëndë apo **15%** nga numri i përgjithshëm i lëndëve në punë kanë mbetur të pakryera.

Mënyra e vendimmarrjes – afat të arsyeshëm

Tituj	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të reja të pranuar	Të pakryera në fund të periudhës	Të kryera	Të pakryera nga periudha e kaluar	Gjithsej në punë
Regjistri për të drejtën e gjyqimit të arsyeshëm - administrative	19	60	41		63	29	120	86	149
Regjistri për të drejtën e gjyqimit të arsyeshëm - penale	6	20	21		44	18	47	21	65
Regjistri për të drejtën e gjyqimit të arsyeshëm - civile	18	49	73		88	9	140	61	149
GJITHSEJ	43	129	135		195	56	307	168	363

Duke marrë parasysh mënyrën e kryerjes së lëndëve në këshillat e shkallës së parë, mund të konstatohet se prej **307** lëndëve të kryera, mbizotëron numri i lëndëve të kryera në të cilat kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim të arsyeshëm është aprovuar, respektivisht është konstatuar shkelja e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe është përcaktuar kompensimi i drejtë në para edhe atë në gjithsej **135** lëndë apo **44%**, prej të cilave **73** lëndë nga materia civile apo **54%**, vijojnë **41** apo **32%** lëndë nga materia administrative dhe **21** apo **15%** nga materia penale.

Prej **307** lëndëve të kryera në këshillat e shkallës së parë, **129** lëndë apo **42 %**, janë kryer me refuzimin e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm si të pabazë. Në këto lëndë mbizotëron numri i lëndëve nga materia administrative - **60** apo **46,5 %**. Numri i lëndëve nga materia civile që kanë qenë të kryera me refuzimin e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm si të pabaza numëron **49** lëndë apo **38%**, ndërsa numri i lëndëve nga materia penale që kanë qenë të kryera me refuzimin e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm si të pabaza numëron **20** apo **15,5%**.

Prej **307** lëndëve të kryera, **43** lëndë apo **14 %**, janë kryer me hedhjen poshtë të kërkesës për mbrojtjen e të drejtave për gjykim në afat të arsyeshëm. Nga gjithsej kërkesat e hedhura poshtë, mbizotërojnë lëndët nga materia administrative - **19** lëndë apo **44 %**, vijojnë **18** lëndë nga materia civile apo **42 %** dhe **6** lëndë nga materia penale apo **14 %**.

Analiza e numrit të lëndëve të kryera në këshillat e shkallës së parë dhe parametrave sipas mënyrës së vendimmarrjes mbi kërkesat për mbrojtjen e të drejtave për gjykim në afat të arsyeshëm në periudhën raportuese, tregon se mbizotëron numri i lëndëve të kryera me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e të drejtave për gjykim në afat të arsyeshëm, përkatësisht përcaktimi i cenimit të procedurës, përcaktimi i kompensimit juridik në para dhe përcaktimi i afatit për përfundimin e procedurës, në qoftë se bëhet fjalë për procedurën në rrjedhë, sidomos në lëndët nga materia civile.

Minimal është numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera dhe i cili numëron **56** lëndë apo **15 %**, nga të cilat mbizotërojnë lëndët nga materia administrative – **29** lëndë apo **52 %**, **18** lëndë apo **32 %** nga materia penale dhe **9** apo **16 %** lëndë nga materia civile.

Duke i marrë parasysh parametrat, të cilat i çmon këshilli gjatë vendimmarrjes së një kërkesë konkrete për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm siç është ndërlkueshmëria e lëndës, kohëzgjatja e procedurës, sjellja e palëve në procedurën dhe sjellja e gjykatës që ka vepruar, cenimet më të shpeshta të procedurës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm e cila ka përfunduar me aprovimin e kërkesës dhe përcaktimi i kompensimit juridik, mund të konstatojmë se lëndët nga materia civile, ndërsa numri më i madh i lëndëve që kanë mbetur në punë janë lëndë nga materia administrative, dhe për shkak të dorëzimit të shkresave të pakompletuara dhe jo në kohë të lëndës nga gjykatat dhe nga organet.

Zgjatja e procedurës në këshillat e shkallës së parë

Në këshillat e shkallës së parë janë kryer **307** lëndë, në të cilat kohëzgjatja e procedurës së kërkesave të deklaruara për mbrojtjen e të drejtës për gjykim të arsyeshëm, përfshin periudhën nga pranimi i kërkesës, përmes dërgimit të shkresave – kërkesë për dorëzimin e lëndëve, formimin komplet të lëndës, përpunimin e raportit me shkrim, referimi i lëndës para anëtarëve të këshillit e madje deri përpunimin me shkrim të vendimit dhe dërgimin e aktvendimit te parashtruesi i kërkesës.

Zgjatja e procedurës – Afat të arsyeshëm për vitin 2022 shkalla e I

Titulli	Gjithsej në punë	Të kryera	Deri në 1 muaj	Deri në 2 muaj	Deri në 3 muaj	Deri në 6 muaj	Mbi 6 muaj	Kanë mbetur për punë
Regjistri për të drejtën e gjykimin të arsyeshëm -civile	149	140	10	21	19	44	46	9
Regjistri për të drejtën e gjykimin të arsyeshëm - penale	65	47		8	7	13	19	18
Regjistri për të drejtën e gjykimin të arsyeshëm - administrative	149	120	8	11	7	18	76	29
GJITHSEJ	363	307	18	40	33	75	141	56

Nga gjithsej **307** lëndët e kryera të shkallës së parë apo **85%**, nga të cilat

- në periudhën deri në **1** muaj, janë kryer **18** lëndë apo **6%**, nga të cilat,
 - PSSRG – 10 lëndë apo **55,5%**
 - PSRRU – 8 lëndë apo **44,5%**
- në periudhën deri në **2** muaj, janë kryer **40** lëndë apo **13%**, nga të cilat,
 - PSRRU – 11 lëndë apo **27,5%**
 - PSSRG – 21 lëndë apo **52,5%**
 - PSRRK – 8 lëndë apo **20%**
- në periudhën deri në **3** muaj, janë kryer gjithsej **33** lëndë apo **11%**, nga të cilat,
 - PSRRU – 7 lëndë apo **21%**,
 - PSRRK – 7 lëndë apo **21%**,
 - PSRRG – 19 lëndë apo **58%**.
- në periudhën deri në **6** muaj, janë kryer gjithsej **75** lëndë apo **24%**, nga të cilat
 - PSRRU – **18** lëndë apo 24%
 - PSRRG – **44** lëndë apo 59%
 - PSRRK – **13** lëndë apo 17%
- në periudhën prej më shumë se **6** muaj, janë kryer **141** lëndë apo **46%**, nga të cilat:
 - PSRRU – **76** lëndë apo **54%**
 - PSRRG – **46** lëndë apo **33%**
 - PSRRK – **19** lëndë apo 13%
- në vitin **2023** kanë mbetur për punë **56** lëndë apo **15%**, nga të cilat:
 - PSRRU – **29** lëndë apo **52%**
 - PSRRG – **9** lëndë apo **16%**
 - PSRRK – **18** lëndë apo **33%**

Dukshëm nga tabela dhe përfaqësimi procentual i kohëzgjatjes së procedurës në këshillat e shkallës së parë, mund të arrihet në përfundim se mbizotëron numri i lëndëve të kryera në periudhën që e tejkalon kornizën e caktuar ligjore. Shkak i tejkalimit të afatit të 6 muajve si kornizë ligjore për kryerjen e këtij lloji të lëndëve në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si edhe vitin e kaluar është mos dërgimi në kohë i shkresave origjinale për lëndët për të cilat ka të bëjë kërkesa për mbrojtjen e të drejtë për gjykim në afat të arsyeshëm. Në fakt, pas pranimit të kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe formimin e lëndës në GJSRMV, detyrë e gjyqtarit – referues në bashkëpunim me bashkëpunëtorin profesional është përpilimi i shkresës – urgjenca me kërkesën e shkresave origjinale nga gjykata apo organi në të cilin është udhëhequr procedura. Vendimmarrja e lëndëve jashtë afatit të paraparë ligjor, është falë dorëzimit jo në kohë të shkresave origjinale të lëndëve të kërkuara edhe krahas dërgimit të disa urgjencave për dorëzimin e shkresave, si të gjykatave ashtu edhe nga ana e organeve të drejtorive në të cilat udhëhiqen procedurat. Në këtë kontekst, Sektori konstaton se mungon mjeti juridik me të cilin Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të imponon detyrë më shpesh për organet e drejtorive, por edhe për gjykatat më të ulëta, për dorëzimin më të shpejtë të shkresave të procedurave gjyqësore që janë objekt i kërkesave për mbrojtjen e të drejtave për gjykim në afat të arsyeshëm, sidomos në rastet kur lënda për të cilën bëhet fjalë në kërkesën për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm është aktive përkatësisht lënda është në rrjedhë, ku procedura e lëndës nuk mund të vazhdojë deri në vendimmarrjen përfundimtare mbi kërkesën për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm. Pamundësia që në të gjitha rastet të respektohet afati prej 6 muajve mbi kërkesën për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm vërehet edhe në periudhat e kaluara raportuese të Sektorit. Ky konstatim ka qenë lëndë e shqyrtimit edhe në seancat e Sektorit, ku janë nxjerrë konkluzione adekuate, të cilat vet në vete nuk mund të japin rezultat, nëse nuk janë të qasura sistematikisht dhe kah shqyrtimi dhe ndryshimi i rregullave proceduese për kryerjen e këtij lloji të lëndës, si dhe objektiviteti i kornizës së vënë ligjore, që nuk korrespondon me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në fakt, me kornizën ligjore prej 6 (gjashtë) muajve, mos krijimi i kushteve proceduese për shpejtimin e procedurës, me mos dërgimin në kohë të shkresave origjinale të lëndës dhe pamundësia proceduese për kryerjen e lëndëve në atë afat edhe në të dyja shkallët e vendimmarrjes në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vet ë vete do të thotë dhënia e mundësisë që palët – kërkuarit të ankohen edhe në zgjatjen e kohës së procedurës edhe në këtë Gjykatë.

Pamundësia e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të gjitha rastet për të respektuar afatin – kornizën prej 6 (gjashtë) muajsh për përfundimin e procedurave të kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, nënkuptojnë edhe obligim për shqyrtimin e afatit ligjor, në kontekst të konsistencës së procedurës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve dhe praktikën e kësaj gjykate. Në këtë kontekst, përsëri potencohet obligimi i kryetarëve të gjykatave, për tu angazhuar për dorëzimin e shkresave të lëndëve, për të cilat bëhet vlerësimi i procedimit në afat të arsyeshëm, e tërë kjo me qëllim që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që të mund të respektojë afatet për gjykim në afat të arsyeshëm, duke marrë parasysh se pasojat e veprimit jo në kohë të duhur sipas detyrimit për dorëzimin e shkresave të lëndëve, të cilat nevojiten për veprimin e kërkesave për gjykim në afat të arsyeshëm, reflektohet në procedimin e tërësishëm për këto lëndë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e me këtë edhe të vlerësimi të efikasitetit për mjetin juridik. Me kuptim të ndjekjes së efikasitetit të mjetit juridik është të insistohet përmes kryetarëve të gjykatave, që me kohë të jepen të dhëna për respektimin e afateve që janë dhënë nga kjo gjykatë për kryerjen e lëndëve që janë në rrjedhë, në fazë të procesit të vendimmarrjes, për të cilën ka të bëjë kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

VËLLIMI I PUNËS, LLOJI DHE MËNYRA E VENDIMMARRJES E KËSHILLIT TË SHKALLËS SË DYTË NË GJYKATËN SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT KOMPETENT PËR TË VENDOSUR MBI ANKESAT E DEKLARUARA KUNDËR AKTVENDIMEVE TË KËSHILLAVE TË SHKALLËS SË PARË

Gjatë vitit **2022**, këshilli i ankesave të shkallës së dytë ka pasur gjithsej **204** lëndë në punë apo **36%** nga gjithsej numri i **567** lëndëve në Sektorin.

Gjithsej numrin e **204** lëndëve të këshillit të ankesave, e përbëjnë **161** lëndë të reja të pranuar apo **79%** dhe **43** lëndë apo **21%** që kanë mbetur të pakryera nga periudha e kaluar raportuese. Këshilli i shkallës së dytë në periudhën raportuese ka kryer **181** lëndë apo **89%**, përderisa **23** lëndë apo **11%** kanë mbetur të pakryera.

Mënyra e vendimmarrjes – afat të arsyeshëm për vitin 2022, shkalla e II

Titulli	Të hedhura poshtë	Të refuzuara	Të aprovuara	Në tjetër mënyrë	Të reja të pranuar	Të pa kryera në fund të periudhës	Të kryera	Të pa kryera nga periudha e kaluar	Gjithsej në punë
Regjistri për të drejtën për gjykim në afat të arsyeshëm për ankesa	3	144	34		161	23	181	43	204
GJITHSEJ	3	144	34		161	23	181	43	204

Këshilli i shkallës së dytë gjatë vitit **2022** ka kryer **181** lëndë apo **89%** nga gjithsej numri i **204** lëndëve në punë, nga të cilat:

- në **144** lëndë apo **80%**, ankesa është e **refuzuar** si e pabazë,
- në **34** lëndë apo **19%**, ankesa është e **aprovuar** dhe
- në **3** lëndë apo **1%**, ankesa është e **hedhur poshtë**,

Analiza e gjithsej numrit të lëndëve të kryera në këshillin e shkallës së dytë të dhënë sipas strukturës tregon tendencë të një periudhe relativisht të shkurtër të veprimit mbi lëndët përkatësisht mbizotëron numri i lëndëve të kryera, ndërsa parametrat e kërkesave të aprovuara, të refuzuara dhe të hedhura poshtë, në periudhën raportuese tregojnë se mbizotëron numri i lëndëve – të kryera me refuzimin e ankesës si të pabazë përkatësisht me konfirmimin e aktvendimit të shkallës së parë në gjithsej **144** lëndë, përkatësisht **80%** nga lëndët në këshillin e ankesave

KOHA E VEPRIMIT TË KËSHILLIT TË SHKALLËS SË DYTË PËR ANKESAT E DEKLARUARA

Kohëzgjatja e veprimit të këshillit të shkallës së dytë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut kompetente për vendimmarrjen e ankesave të deklaruara kundër aktvendimeve të shkallëve të parë, përfshin periudhën nga pranimi i ankesës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri në dërgimin e aktvendimit të shkallës së dytë te parashtruesi i kërkesës.

Zgjatja e procedurës – afat të arsyeshëm për vitin 2022, shkalla e II

Titulli	Gjithsej në punë	Të kryera	Deri në 1 muaj	Deri në 2 muaj	Deri në 3 muaj	Deri në 6 muaj	Mbi 6 muaj	Kanë mbetur për punë
Regjistri për të drejtën për gjykim në afat të arsyeshëm për ankesa	204	181	39	66	39	35	2	23
GJITHSEJ	204	181	39	66	39	35	2	23

Nga gjithsej numri i **204** lëndëve në punë në këshillin e ankesave të shkallës së dytë, përkatësisht nga **181** lëndët e kryera:

- për periudhën deri në **1** muaj procedura ka përfunduar në **39** lëndë apo **21,5%**,
- për periudhën deri në **2** muaj procedura ka përfunduar në **66** lëndë apo **36%**,
- për periudhën deri në **3** muaj procedura ka përfunduar në **39** lëndë apo **21,5%**,
- për periudhën deri në **6** muaj procedura ka përfunduar në **35** lëndë apo **20%**,
- për periudhën me mbi **6** muaj procedura ka përfunduar në **2** lëndë apo **1%**,
- kanë mbetur për punë në vitin **2022 - 23** lëndë apo **11%**.

Analiza e kohës për kryerjen e lëndëve në këshillin e ankesave, tregon **respektimin relativ të afatit prej 6 muajsh**, si kornizë ligjore për vendimmarrjen e lëndëve edhe në të dyja shkallët e vendimmarrjes në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo, veçanërisht sepse gjatë procedimit të kornizës ligjore prej 6 muajsh nuk është marrë parasysh koha e nevojshme për dorëzimin e lëndëve të kryera në shkallën e parë drejtuar palëve dhe rrjedhja e afatit për ankesë. Nga këtu, koha e vendimmarrjes së lëndëve në këshillin e ankesave të marrë vetëm për vete determinon se, afati për procedimin sipas këtij lloji të lëndëve në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është jo konsekuente me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve.

Kompensimi i drejtë

Nga gjithsej **488** lëndët e kryera të këtij Sektori, nga të cilat **307** lëndë në shkallën e parë dhe **181** lëndë në shkallën e dytë, për të cilat është marrë vendim në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm, në vitin **2022**, shuma **maksimale** e shqiptuar në emër të kompensimit të drejtë, për shkak të cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, në këshillat e shkallës së parë në **169** kërkesa të **aprovuara** numëron **1.150.000** denarë dhe ka të bëjë për më shumë parashtrues, të cilët të drejtën e tyre për gjykim në afat të arsyeshëm e kanë realizuar me një kërkesë, përderisa shuma e shqiptuar **minimale** në **këshillat e shkallës së parë** është **5.000** denarë. Shuma maksimale e shqiptuar në emër të kompensimit të drejtë është për shkak të cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm **në këshillin e ankesave të shkallës së dytë**, në **34** ankesa të **aprovuara**, numëron **40.000** denarë, ndërsa shuma **minimale** në emër të kompensimit të drejtë nga ana e shkallës së dytë numëron **3.900** denarë.

Nga **488** lëndët e kryera në këtë Sektor, në vitin **2022**, përkatësisht **135** kërkesa të aprovuara në **shkallën e parë** është shqiptuar kompensim i drejtë në vlerë prej **5.321.802** denarë kurse në **këshillin e ankesave të shkallës së dytë** përkatësisht në **34** ankesat e aprovuara kompensimi i shqiptuar është **311.900** denarë apo shuma totale në **të dyja** shkallët e vendimmarrjes për **169** kërkesa të aprovuara numëron **5.633.702** denarë, në emër të kompensimit të drejtë për shkak të cenimit të konstatuar për të drejtën për gjykim në afat të arsyeshëm dhe për shpenzimet e procedurës për kërkesat e parashtruara për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Seanca e Sektorit

Në seancat e Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm, janë shqyrtuar çështje të rëndësishme juridike, të cilat burojnë nga lëndët e formuara të kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, dhe njëkohësisht janë shqyrtuar edhe raportet mujore të punës së këshillave të këtij Sektorit.

Gjatë vitit 2022, Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm mbajti 3 (tre) seanca edhe atë më **22.03.2022, 18.04.2022 dhe më 28.11.2022**, në të cilat përveç çështjeve të parashtruara me kuptim të punës së Sektorit, siç janë lëvizja apo qarkullimi i lëndëve dhe raportet mujore, u miratua edhe një mendim juridik.

SEKTORI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

Sipas Ligjit për gjykatat, Rregullores gjyqësore, Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Programit të punës së Sektorit të praktikës gjyqësore për vitin 2022, Sektori i praktikës gjyqësore gjatë vitit 2022, ka punuar në realizimin e qëllimit themelor, drejtimet dhe prioritetet në unifikimin e zbatimit të ligjit dhe ndjekjes së praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vëllimi dhe cilësia e punës

Sektori i praktikës gjyqësore, në kuadër të punës së tij të rregullt, mbajti 4 seanca gjatë vitit 2022, të evidentuara nën SPZ numër.

Në realizimin e qëllimit themelor – ndjekja konsekuente dhe unifikimi i praktikës gjyqësore, Sektori i praktikës gjyqësore gjatë vitit 2022, qëndrimet e miratuara juridike të Seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mendimet juridike, konkluzionet dhe sentencat e sektorëve të specializuar, i evidentoi në një regjistër të posaçëm dhe në mënyrë elektronike me sistematizimin e fushave juridike, në mënyrë që i publikoi në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pjesën e praktikës gjyqësore

Në vitin 2022, në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë publikuar një (1) qëndrim parimor dhe një (1) plotësim i qëndrimit parimor, dymbëdhjetë (12) mendime juridike dhe një (1) plotësim i mendimit juridik, dy (2) konkluzione dhe pesë (50) sentenca, për të cilat në vazhdim është dhënë përshkrimi:

Qëndrime parimore të miratuara nga Seanca e përgjithshme:

- Publikimi i vendimeve të pa plotfuqishme
- Plotësimi i qëndrimit parimor të datës 28.04.2021, në lidhje me kompetencën e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Mendime juridike të miratuara nga Sektori i veprave civile:

- Përmbartimi i kërkesës në para ndaj RMV dhe organeve të saj – përcaktimi i mjeteve minimale për kryerjen e veprimtarisë
- Përcaktimi i vlerës së tregut të patundshmërisë së eksproprijuar
- Kompensimi i shtesave të patundshmërisë së eksproprijuar
- Shpërblimi për ndihmën juridike të një avokati në kontestet për ndryshimin e asistencës
- Konflikti i kompetencave ndërmjet Gjykatës Themelore dhe asaj Administrative për shkarkimin e drejtorit të një institucioni
- Shtesa për shkallën e karrierës
- Kompetenca për përmbartimin e vendimeve gjyqësore me të cilat përcaktohen masa të përkohshme
- Caktimi i gjyqit tjetër kompetent real
- E drejta e regresit për dëmin e shkaktuar nga automjeti motorik i pasiguruar
- Legjitimacioni aktiv i një shoqërie të avokatit në konteste të kërkesave të mëparshme të avokatëve – themelues të shoqërisë së avokatit
- Plotësimi i mendimit juridik – Kompetenca për përmbartimin e vendimeve gjyqësore me të cilat përcaktohen masa të përkohshme

Mendim juridik i miratuar nga Seanca e Sektorit të veprave penale:

- paraburgimi ekstradues dhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimit me burg

Mendim juridik i miratuar nga Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm:

- Vendimmarrja e kërkesës për gjykim në afat të arsyeshëm e parashtruar nga më shumë persona në procedurën e falimentimit

Konkluzione të nxjerra nga Sektori i veprave penale:

- Konkluzione për zbatimin e principeve dhe qëndrimeve të GJEDNJ në aktgjykimet Boshkoski kundër RMV dhe Janevski kundër RMV.

- Konkluzion i zbatimit të principit për gjykim të drejtë implementuar në aktgjykimin e GJEDNJ Transkop SHA Manastir kundër RMV.

Sentenca të miratuara nga Sektori i veprave civile:

- Kontributi i këmbësorit si pjesëmarrës në fatkeqësi komunikacioni

Sentenca të miratuara nga Sektori i veprave penale:

- Gjykata kompetente për fshirjen e dënimit

- Ndjekja me propozim të një personi tjetër si i dëmtuar

- Mungesa e një mjeti efektiv juridik të personave të tretë

- Kohëzgjatja e paraburgimit shtëpiak me ndryshimin e paraburgimit

Në vitin 2022, Sektori i praktikës gjyqësore ka bërë seleksionimin, evidentimin dhe sistematizimin mbi fushat juridike të vendimeve të marra me rëndësi juridike (vendime të rëndësishme) të këshillave gjyqësorë të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në dosjen “Praktika gjyqësore”, që paraqet bazën e brendshme të së dhënave që është në dispozicion për të gjithë gjyqtarët dhe këshilltarët profesional gjyqësor të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Njëkohësisht, nga ana e Sektorit të praktikës gjyqësore janë ndjekur vendimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa me qëllim për unifikimin e praktikës gjyqësore është bërë kërkimi i vendimeve të ngjashme apo identike në bazën e të dhënave që e ka Sektori i praktikës gjyqësore, në AKMIS programin përmes sporteleve dhe të UEB faqes së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilën publikohen vendimet gjyqësore të anonimizuar.

Gjatë vitit, Sektori i praktikës gjyqësore ka punuar 13 lëndë, të evidentuara nën SPR numër, të formuara sipas shkresave lidhur me zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe unifikimin e praktikës gjyqësore dhe pas shkresave të dorëzuara nga Ministria e Drejtësisë Byroja për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa në lidhje me praktikën gjyqësore dhe lëndët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut udhëhiqen në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.

Sektori i praktikës gjyqësore, e ndoqi praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg përmes analizës së vendimeve dhe seleksionimit të tyre me qëllim implementimin më të lehtë të tyre në vendimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aktgjykimet e miratuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë përditësuar vazhdimisht në nëndosjet e dosjes “Praktika gjyqësore të GJEDNJ”, i krijuar në dosjen ekzistuese “Praktika gjyqësore”, që në mënyrë të brendshme janë të arritshme për të gjithë gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional gjyqësorë.

Aktivitete tjera

Përfaqësues nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kanë marrë pjesë në takimin e gjykatave të apelit për harmonizimin e praktikës gjyqësore, që u mbajt më 08 dhe 09 qershor 2022, në Gjevgjeli.

Gjatë vitit 2022, janë ndërmarrë aktivitete lidhur me përmirësimin e bazës së praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në kuadër të projektit “Iniciativa për sigurim juridik në Ballkanin perëndimor”, që rezulton me dizajnin e sistemit të brendshëm informatik për praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në implementimin e të cilit do të punohet në periudhën që vijon.

PUNA E SEANCËS SË PËRGJITHSHME TË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Sipas Ligjit për gjykatat, në plotësim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, kryetari dhe të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut morën pjesë në punën e Seancës së përgjithshme.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit **2022** ka mbajtur **23 Seanca të përgjithshme**, në të cilat janë shqyrtuar disa çështje:

- Seanca e përgjithshme shqyrtoi 24 iniciativa për miratimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore.

- Janë miratuar 1 (një) qëndrim parimor dhe 1 (një) plotësim i qëndrimit parimor.

- Është nxjerrë 1 (një) konkluzion për parashtrimin e propozim iniciativës në Ministrinë e Drejtësisë për ndryshimin e dispozitave të ligjit.

- Janë nxjerrë 23 konkluzione mbi iniciativat për miratimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore.

- Janë dhënë 8 (tetë) mendime me propozim ligje dhe rregulla tjera kur me to rregullohen çështje me domethënie për punën e gjykatave.

- Janë emëruar 4 (katër) Këshilla për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Seanca e përgjithshme shqyrtoi për 2 (dy) kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

- Është miratuar Raporti i punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021.

- në Seancën e zgjeruar të përgjithshme janë shqyrtuar Raportet e punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021.

- Janë miratuar Vlerësimet dhe konkluzionet e raporteve për punën e gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021.

- Seanca e përgjithshme me kërkesë të mendimit nga Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut për numrin orientues të lëndëve që çdo gjyqtar duhet ti kryejë në muaj për shkak të miratimit të Vendimit për normën orientuese për vitin 2022, dha mendim se gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk duhet të detyrohen me normë orientuese.

- U emërua një anëtarë dhe një zëvendës i anëtarit të Bordit drejtues të Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publik nga radha e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Janë miratuar raportet nga vizitat e realizuara të punës në Gjykatën e Apelit Shkup dhe Gjykatën e Apelit Shtip.

- Seanca e përgjithshme vendosi mbi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga Këshillat për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për përjashtimin e anëtarëve të Këshillit për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Është siguruar mendimi për Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023.

- Seanca e përgjithshme dha 3 (tre) mendime me kërkesën e kryetarit të gjykatës, për sistemimin e gjyqtarëve nga një sektor në tjetër.

- Vendosi për 2 (dy) kundërshtime të gjyqtarëve kundër vendimeve për orarin vjetor të punës, të miratuar nga ana e kryetarëve të gjykatave.

- Vendosi mbi 7 (shtatë) kundërshtime të gjyqtarëve kundër vendimeve për ndryshimin dhe plotësimin e orarit vjetor të punës, të miratuar nga ana e kryetarëve të gjykatave.

Seanca e gjyqtarëve

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit **2022** ka mbajtur **3 Seanca të gjyqtarëve** në të cilat janë shqyrtuar këto çështje:

- Zbatimi i Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Shqyrtimi i konkluzioneve të Këshillit Drejtues të Shoqatës së gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Informacioni për pjesëmarrjen e gjyqtarëve në këshillime të ndryshme dhe vizita të realizuara në vend dhe jashtë vendit.

RESURSE NJERËZORE

Me vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është përcaktuar që funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ta realizojnë 28 gjyqtarë. Megjithatë si edhe vitet e kaluara edhe këtë vit gjyqtarit i cili është zgjedhur anëtarë i Këshillit gjyqësor, vendi i gjyqtarit i pezullohet.

Në periudhën prej 31.12.2021 deri më 31.01.2026 njërit prej gjyqtarëve me kërkesë të tij i është pezulluar funksioni i gjyqtarit.

Vitin raportues Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut e filloi me 17 gjyqtarë. Në muajin prill 2022, 1 gjyqtarë është shkarkuar nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit për shkak të kryerjes joprofesionale dhe pa ndërgjegje të funksionit të gjyqtarit, ndërsa në muajin korrik 2022, 2 gjyqtarëve u është përcaktuar ndërprerja e funksionit të gjyqtarit për shkak të kushteve të plotësuara për pensionim. Në fund të vitit funksionin e gjyqtarit e kanë ushtruar 14 gjyqtarë të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të Vendimit nga ana e Këshillit gjyqësor, në korrik 2021 është shpallur konkurs për zgjedhjen e katër gjyqtarëve, megjithatë deri në fund të vitit 2022 zgjedhja nuk u realizua.

Nga e tërë sipër ekspozuara rezulton se, Gjykata në vitin raportues ka funksionuar me përbërje jo të plotë të gjyqtarëve në kufij me minimumin e duhur për funksionimin normal të Gjykatës, duke marrë parasysh kompetencat e saj, punën e Seancës së përgjithshme, punën e katër gjykatave të apelit, Sektorin e veprave penale, Sektorin e veprave civile, Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm dhe Sektorin e praktikës gjyqësore, që shkakton një numër të konsiderueshëm të përjashtimit dhe nevojën për riorganizimin dhe ri sistemimin me angazhim në vazhdimësi edhe të bashkëpunëtorëve profesional gjyqësor në disa këshilla.

Sipas Ligjit për gjykatat, Ligjit për shërbim gjyqësor, Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës dhe Planit vjetor për punësim është përcaktuar organizim i brendshëm, vendet e punës dhe numri i realizuesve të nevojshëm për realizimin e kompetencave të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nga numri i paraparë i nëpunësve gjyqësorë në Rregulloren, që sipas Ligjit për shërbim gjyqësor klasifikohen në tre grupe (udhëheqës, profesional dhe nëpunës ndihmës profesional gjyqësor), mund të konstatohet se numri i nëpunësve gjyqësorë në gjykatë absolutisht nuk i plotëson nevojat sipas vëllimit dhe ndërlikueshmërisë së kompetencës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjykatë më e lartë e vendit.

Në periudhën e kaluar konstatohet një fluks i vazhdueshëm dhe zbrazje e vendeve të punës nga të gjitha kategoritë e të gjithë nëpunësve gjyqësorë për shkak të shkuarjes në institucione tjera dhe me bazë për pensionim.

Duke qenë se vendet e tilla të zbrazura nuk plotësohen në kohë të duhur, për shkak të mos marrjes së pëlqimit dhe miratimit nga Ministria e financave për publikimin e shpalljeve, mungesën e punëtorëve kompensohet me orarin e punës, për shkak të së cilës një periudhë të gjatë kohore punëtorët realizojnë disa punë.

Në fillim të vitit 2022 është marrë ripërtëritja e pëlqimit për sigurimin e mjeteve financiare për punësimin e nëpunësve gjyqësorë me konkurs të shpallur publik 1/2021 dhe në mars 2022 janë realizuar punësime të 5 nëpunësve gjyqësorë edhe atë për vendin e punës Udhëheqës i Sektorit për punë materiale dhe financiare 1 (një) realizues, për vendin e punës Këshilltarë i pavarur gjyqësor 3 (tre) realizues dhe për vendin e punës Këshilltar i pavarur gjyqësor në Këshillin e shërbimit gjyqësor 1 (një) realizues.

Në shtator 2022 pas pëlqimit të marrë, janë realizuar 8 (tetë) avancime të nëpunësve gjyqësor me publikimin e shpalljes së brendshme dhe janë realizuar punësime të 3 nëpunësve gjyqësor me publikimin e shpalljes publike edhe atë për vendin e punës Këshilltar gjyqësor me publikimin e shpalljes publike edhe atë për vendin e punës Këshilltar gjyqësor 1 (një) realizues, për vendin e punës Referent i pavarur-kontabilist 1 (një) realizues dhe për vendin e punës Mbajtës të higjienës 1 (një) realizues.

Nëse merret parasysh edhe periudha e kaluar me vendet e zbrazura të punës me bazë për pensionim, për shkak të kalimit në institucione tjera tregon se numri i nëpunësve gjyqësorë në gjykatë absolutisht nuk i plotëson nevojat. Në momentin, në tre sportelet, në atë penale, civile dhe në atë për gjykim në afat të arsyeshëm, punojnë 7 (shtatë) nëpunës ndihmës profesional gjyqësor, nga të cilët 3 (tre) nëpunës gjyqësor janë me titullin referent i pavarur gjyqësor – udhëheqës i sportelit, ndërsa 4 (katër) nëpunësit tjerë gjyqësor janë sistemuar me Orarin vjetor për vitin 2022.

Gjykata Supreme vitin 2022, e përfundoi me 59 nëpunës të punësuar gjyqësor nga kategoritë nëpunës udhëheqës, profesional dhe ndihmës profesional gjyqësor, 5 përkatës së policisë gjyqësore dhe 7 të punësuar në shërbimin teknik. Kështu numri i zvogëluar i nëpunësve gjyqësor nuk korrespondon me vëllimin e punës dhe numrin e gjyqtarëve.

QENDRA E INFORMATIKËS

Në Qendrën e informatikës, së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është vendosur pajisje harduerike – softuerike e tërësishme nga sfera e IKT dedikuar për funksionimin papengesë të GJSRMV dhe një pjesë për gjykatat e RMV dhe KGJRMV. Plotësuese në Qendrën e informatikës janë vendosur baza të caktuara të centralizuara për të dhënat, funksionalitetin e centralizuar, këmbimin e të dhënave të centralizuara me institucione nga jashtë etj., që dedikohen për punën pa pengesë për të gjitha gjykatat. Aktivitetet themelore për funksionimin pa pengesë për implementimin e sistemit IKT (planifikimin, pjesëmarrjen në projekte IKT zhvilluese, administrimin, menaxhimin, monitorimin, mbrojtjen, sigurinë, prokurime publike të centralizuara, përkrahja e shfrytëzuesve etj.) janë në perimetër të detyrave punuese të gjithsej 4 (katër) IKT inxhinierëve të punësuar në Qendrën e informatikës së GJSRMV.

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në funksion janë aplikacionet e shfrytëzuesve nga sfera e IKT me tendencë të rritjes së tyre në periudhën e ardhshme siç vijon:

- Aplikacioni për administrimin e qarkullimit të lëndëve gjyqësore (AKMIS).
- Baza e centralizuar për nevojat nomenklature të AKMIS sistemit për të gjitha gjykatat
- Aplikacioni për punën financiare dhe materiale (ABMS).
- Aplikacioni për publikimin e praktikës gjyqësore, të Gjykatës Supreme të RMV dhe vendime të gjykatave të apelit në Ueb faqen për praktikën gjyqësore.
- Aplikacioni për publikimin e vendimeve gjyqësore, informacioneve, informacione të reja, të dhëna statistikore e të dhëna tjera të faqes zyrtare të Gjykatës Supreme të RMV.
- Vendosja e centralizuar të Ueb Portalit gjyqësor dhe WEB portaleve për të gjitha gjykatat e RMV.
- Sistemi i postës elektronike dedikuar për të punësuarit në Gjykatën Supreme të RMV dhe për njoftimin e shfrytëzuesve të sistemit për Dorëzimin elektronik të dokumenteve gjyqësore
- Aplikacioni për dorëzimin elektronik të dokumenteve gjyqësore (faza e parë – dorëzimi nga gjykatat të shfrytëzuesit), dedikuar për të gjitha gjykatat e RMV, me bazë të centralizuar për të dhënat e vendosura në sëndukët elektronik, të vendosur në Qendrën e informatikës të Gjykatës Supreme të RMV.
- Aplikacioni i evidencës ndëshkuese e dedikuar për të gjitha gjykatat e RMV, me bazë të centralizuar të vendosur në Qendrën e informatikës të Gjykatës Supreme të RMV.
- Backup (kopje) të centralizuar të AKMIS bazave për të dhënat nga të gjitha gjykatat e RMV.
- Servisi i centralizuar për këmbimin e të dhënave të drejtorëve të falimentimit me Regjistër Qendror të RMV, dedikuar për të gjitha gjykatat me kompetencë të zgjeruar.
- Servisi i centralizuar për këmbimin e të dhënave ndërmjet gjykatave dhe prokurorive të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Servisi i centralizuar për këmbimin e të dhënave ndërmjet gjykatave dhe Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Servisi i centralizuar për lëshimin elektronik të vërtetimeve nga baza për evidentimin përmes sistemit për interoperabilitet të MSHIA

- Aplikacioni për rregullimin dhe kërkimin e vendimeve gjyqësore të praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të RMV.
IKT inxhinierët e punësuar në Qendrën e informatikës, të Gjykatës Supreme të RMV, gjatë vitit 2022 kanë realizuar aktivitetet në vijim:
- Konstatimin e nevojave, përpunimin e specifikimit teknik të detajuar dhe kriteret për konstatimin e aftësisë, pjesëmarrjen në evoluim dhe realizimin (dhënia e përkrahjes teknike dhe ndjekja e përparimit në përputhje me planet e nënvizuara me afat) të procedurave për prokurim publik, të cilat i përfshijnë nevojat e të gjitha gjykatave të RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV nga sfera e IKT siç vijon:
 1. Mirëmbajtja harduerike – softuerike të pajisjes, të siguruar në kuadër të projektit IPA2010 kryesisht mirëmbajtjen preventive dhe adaptuese të ueb faqeve së të gjitha gjykatave të RMV dhe të Këshillit gjyqësor të RMV
 2. Mirëmbajtja adaptuese dhe preventive e sistemit AKMIS të implementuar në gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut përfshirë edhe mirëmbajtjen e aplikacioneve plotësuese dhe servisimin integruar në të njëjtin
 3. Mirëmbajtjen e Platformës IBM Lotus Domino, sistemin e – mail dhe aplikacionin ueb për publikimin e vendimeve nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të RMV
 4. Mirëmbajtjen harduerike – softuerike dhe parapagesën vjetore të softuerit të Firewall Check Point arkitekturën e implementuar në të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV.
 5. Mirëmbajtjen harduerike – softuerike dhe parapagesën vjetore softuerike të VMware infrastrukturën e implementuar në të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV.
 6. Mirëmbajtja harduerike – softuerike dhe parapagesa vjetore e sistemit për mbrojtjen e bazave për të dhënat e të gjitha gjykatave të RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV.
 7. Mirëmbajtjen e softuerit për grumbullimin, analizën dhe kërkimin e shënimeve log të pajisjeve të IKT të vendosura në GJSRMV
 8. Mirëmbajtjen e post – garancisë së sistemit për klimatizimin preciz në sistem sallën e Gjykatës Supreme të RMV.
 9. Furnizimi me materialet AOP për nevojat e Gjykatës Supreme të RMV
 10. Realizimi i furnizimit të serverëve të rinj dhe IKT pajisjeve tjera për funksionimin papengesë të sistemit AKMIS me të gjitha mbindërtimet
 11. Pjesëmarrje në Grupin punues të formuar nga Këshilli gjyqësor të RMV për përpunimin e specifikimit teknik dhe kriterëve për konstatimin e aftësive në procedurën për furnizimin e internet lidhjeve për të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV
 12. Pjesëmarrje në përpunimin e specifikimit teknik dhe realizimin e projektit për rregullimin e vendimeve gjyqësore nga praktika gjyqësore të Gjykatës Supreme të RMV.
- Ndjekja e vazhdueshme e gjendjes dhe ndërmarrja e aktiviteteve adekuate me qëllim të funksionimit papengesë të aplikacioneve të implementuara, të shfrytëzuesve, të dedikuara për GJSRMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV, në të gjitha fazat e zbatimit të tyre:
 - o Vërejtjen e pengesave të paraqitura, probleme të papritura, vërejtje dhe korrespondenca me përgatitësin e aplikacionit shfrytëzues për mënjanimin e tyre.
 - o Perceptimi i nevojave eventuale nga mbindërtimi dhe përmirësimi
 - o Ndarja adekuate e të drejtave të shfrytëzuesve dhe privilegjet
 - o Mbështetja e shfrytëzuesve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët drejtohen në Qendrën e informatikës dhe kërkojnë ndihmë
 - o Përpunimi i raporteve të ndryshme statistikore për nevojat e shërbimeve gjyqësore dhe institucionet tjera
- Planifikimi i mjeteve të nevojshme financiare për investimin dhe mirëmbajtjen në sferën IKT për të gjitha gjykatat e RMV dhe KGJRMV, planifikimin e nevojshëm për edukimin e vazhdueshëm të kuadrove IKT të punësuar në gjykatat e RMV dhe planifikimi i nevojshëm për punësime të reja të kuadrove profesionale IKT në Qendrën e informatikës së Gjykatës Supreme të RMV.
- Administrimi gradual, menaxhimi dhe ndjekja e sistemeve IKT të cilat janë të vendosura në Qendrën e informatikës së Gjykatës Supreme të RMV, të dedikuara për Gjykatën supreme të RMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV.
- Realizimi i përditshëm dhe kontrollimi i procedurave për mbrojtjen e të dhënave sistemuere dhe shfrytëzuesve (backup), të dedikuara për Gjykatën supreme të RMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV.

- Monitorimin e logo sistemeve për paraqitjen e gabimeve të pajisjes së tërësishme të IKT, të vendosur në Qendrën e informatikës të Gjykatës supreme të RMV, me qëllim për mënjanimin eventual të problemeve që hasen.
- Ndjekja në vazhdimësi e performancave të sistemeve IKT, të vendosura me qëllim për marrjen e aktiviteteve përkatëse ose pasqyrimin e nevojave për përmirësimin e tyre.
- Mirëmbajtja në vazhdimësi dhe administrimi i stacioneve punuese, notebook, kompjuterëve, printerëve, skanerëve.
- Bashkëpunimin dhe koordinimin e Qendrës së informatikës të GJSRMV me sektorë të informatikës të gjykatave në RMV dhe KGJRMV, me qëllim të dhënies së rekomandimeve dhe udhëzimeve për marrjen e aktiviteteve të caktuara lidhur me funksionet e centralizuar, njoftimet për mirëmbajtjen e sigurt të sistemeve IKT të caktuara, procedura për lajmërimin e problemeve të shfaqura, dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm etj.
- Ndjekja e vazhdueshme e teknologjive dhe trendëve të reja në sferën e IKT (pa edukim adekuat) duke shfrytëzuar literaturë që është në dispozicion në Internet.
- Udhëheqja me dokumentacion të rregullt për realizimin e aktiviteteve sistemuese dhe shfrytëzuese, probleme të shfaqura, mënjanimin e tyre, udhëheqjen me raporte mujore për realizimin e detyrave punuese të IKT inxhinierëve nga Qendra e informatikës së GJSRMV dhe të ngjashme.
- Pjesëmarrja në punën e Këshillit të ri, të formuar për IKT në gjyqësinë, pjesëmarrja në takime pune për planifikimin dhe realizimin e projekteve IPA, pjesëmarrja në takime pune duke përfshirë edhe përpunimin dhe dorëzimin e të dhënave të nevojshme drejtuar ekspertëve të angazhuar në kuadër të projekteve IPA për mbështetjen e reformave në gjyqësinë, pjesëmarrja në Grupin punues për përshtatjen e Rregullores gjyqësore me rregullat e vlefshme ligjore etj.

Sipas të gjitha trendëve shoqërore bashkëkohore, imponohet nevoja për futjen e vazhdueshme të teknologjive të reja informatike dhe sistemeve IKT në sistemin gjyqësor të RMV, që të mundet përmes teknologjisë informatike bashkëkohore, edukative, pajtueshmëri dhe unifikim të arrihet qëllimi përfundimtar, realizimi i lidhshmërisë efikase në të gjitha gjykatat e territorit të RMV dhe këmbimi i të dhënave me institucione tjera. Ajo, vazhdimisht me automatizëm dhe dukshëm e zmadhon vëllimin e punës së vetëm 4 (katër) IKT inxhinierëve që janë në Qendrën e informatikës pranë GJSRMV.

Adekuatë për të, është evidente dhe e domosdoshme nevoja për punësimin e vazhdueshëm të IKT inxhinierëve profesional në Qendrën e informatikës, të cilëve do t'iu mundësohet edukim i vazhdueshëm dhe adekuat duke marrë parasysh se teknologjia e informatikës është sistemi më dinamik në çdo shoqëri bashkëkohore.

RAPORTI PËR FURNIZIMET PUBLIKE TË PLANIFIKUARA DHE TË REALIZUARA

Në aspektin e planifikimit dhe realizimit të furnizimeve publike në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2021, ju njoftojmë si në vijim:

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut për realizimin e furnizimeve publike, sipas Ligjit për furnizime publike ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.24/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.87/21 dhe Rregullorja për formën, përmbajtjen si dhe mënyrën e përgatitjes së planit vjetor për furnizimet publike ("Gazeta zyrtare e RM" nr.64/19), në vitin 2022 ka sjellë:

- Planit vjetor për furnizime publike në vitin 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut 02Su.nr.20/22 të datës 31.01.2022;
- Ndryshimi dhe plotësimi i Planit vjetor për furnizimet publike në vitin 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut 02Su.nr.27/22 të datës 11.02.2022;
- Plotësimi i Planit vjetor për furnizimet publike në vitin 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut 02Su.nr.115/22 të datës 31.03.2022;
- Ndryshimi dhe plotësimi i Planit vjetor për furnizime publike në vitin 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut Su.02. nr.193/22 të datës 10.05.2022;
- Plotësimi i Planit vjetor për furnizime publike në vitin 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut Su02.nr.497/22 të datës 09.11.2022, dhe
- Plotësimi i Planit vjetor për furnizime publike në vitin 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut Su02.nr.520/21 të datës 21.11.2022.

Me Planin vjetor për furnizimet publike në vitin 2022, si dhe me plotësimet e të njëjtit, është parashikuar që në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të bëhen 33 (tridhjetë e tre) furnizime publike, nga të cilat:

- 16 (gjashtëmbëdhjetë) furnizime publike sipas vlerës së parashikuar të realizohen si furnizime me vlerë të vogël;
- 9 (nëntë) furnizime publike sipas vlerës së parashikuar të realizohen me zbatimin e një procedurë më të thjeshtë të hapur, dhe
- 8 (tetë) furnizime publike sipas vlerës së parashikuar të realizohen me zbatimin e procedurës së hapur.

Nga 33 (tridhjetë e tre) furnizimet publike 5 (pesë) furnizime publike janë paraparë si të grupuara, edhe atë:

- Furnizimi me energji elektrike është paraparë si furnizimit grupor publik që do të realizohet përmes Gjykatës Themelore Civile Shkup me realizimin e procedurës civile;
- Furnizimi me pajisje informatike për nevojat e Këshillit gjyqësor të RMV dhe gjykatat në RMV është parashikuar si furnizim grupor publik që do të realizohet përmes Këshillit gjyqësor të RMV me realizimin e procedurës së hapur, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të buxhetit gjyqësor për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për realizimin e furnizimeve grupore publike për vitin 2022 nr.02-155/15 të datës 07.02.2022;
- Furnizimi i shërbimeve për telefona celularë për periudhën prej 2 (dy) viteve është paraparë si furnizimi i grupuar publik që do të realizohet përmes Këshillit gjyqësor të RMV me realizimin e procedurës së hapur, dhe në bazë të Vendimit për realizimin e furnizimeve grupore publike për vitin 2022 nr. 02-155/15 të datës 07.02.2022;
- Furnizimi i shërbimeve të internetit për periudhën prej 12 muajve është paraparë si furnizim grupor publik që do të realizohet përmes Këshillit gjyqësor të RMV me realizimin e procedurës së hapur dhe në bazë të Vendimit për realizimin e furnizimeve grupore publike për vitin 2022 dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të buxhetit gjyqësor nr.02-155/15 të datës 07.02.2022, dhe
- Furnizimi me energji elektrike për vitin 2023 është paraparë si furnizim grupor publik që do të realizohet përmes Gjykatës Themelore Civile me realizimin e procedurës së hapur.

PARALAJMËRIME:

Shtatë nga procedurat e furnizimeve publike ishin anuluar dhe përsëri u publikua shpallje për realizimin e tyre.

Pas kësaj, pesë nga procedurat ishin anuluar për shkak se oferta me çmim më të ulët e tejkalonte shumën e siguruar të furnizimit, dhe si rezultat i rritjes së përgjithshme të çmimeve të cilat nuk mund të planifikoheshin adekuat gjatë përgatitjes së Planit vjetor për furnizime publike në vitin 2022.

Gjashtë nga këto procedura më vonë u realizuan me sukses dhe është lidhur marrëveshje me operatorin ekonomik që është zgjedhur si më i volitshëm.

Procedura për furnizimin grupor të energjisë elektrike për vitin 2023 të datës 10.01.2023 u anulua për të dytën herë për shkak që edhe në shpalljen e dytë publike nuk u paraqit asnjë ofertues.

Furnizime publike të planifikuara dhe të realizuara

1. Furnizimi me materiale për AOP për periudhën prej 1 (një) viti, shpallje nr.02079/2022
2. Qiraja e një monedhe me dy fibra optike (single mode - Dark Fiber), shpallje nr.02407/2022
3. Furnizimi me pajisje të UPS, shpallje nr.05320/2022
4. Mirëmbajtja preventive dhe post – garancia e pajisjes harduerike – softuerike, të siguruar në kuadër të projektit IPA2010 për nevojat e gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën prej 1 (një) viti, shpallje nr. 05513/2022
5. Kontrollat shëndetësore të punësuarve në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.06673/2022

6. Furnizimi me ujë të pa gazuar, ujë të gazuar dhe lëngje për periudhën prej 1 (një) viti, shpallje nr.07064/2022
7. Mirëmbajtja e post – garancisë së sistemit për klimatizimin preciz në sallën e sistemit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën prej 1 (një) viti, shpallja nr. 07969/2022
8. Mbështetja dhe mbindërtimi i sistemit për rrjetin pa tel në ndërtesën e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën prej 1 (një) viti, shpallje nr.07971/2022
9. Parapagesa vjetore e softuerit dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e harduerit dhe softuerit sistematik për funksionimin e sistemit AKMIS dhe pajisjes për udhëheqjen e evidencës ndëshkuese në gjykatat e RMV, shpallje nr.09309/2022
10. Furnizimi me shërbime për mirëmbajtjes e IBM Lotus Notes platformës, sistemin e e-majlit dhe ueb aplikacionin për publikimin e vendimeve nga praktika gjyqësore të GJSRMV, publikimin e vendimeve më të rëndësishme të katër gjykatave të apelit dhe aktgjykimet e GJEDNJ kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, shpallje nr.09314/2022
11. Mbështetja dhe mbindërtimet e sistemit të rrjetit pa tel në ndërtesën e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën prej 1 (një) viti, shpallje nr.09476/2022
12. Furnizimi me ujë të pa gazuar, ujë të gazuar dhe lëngje për periudhën prej 1 (një) viti, shpallje nr. 09762/2022
13. Mirëmbajtja e post – garancisë së sistemit për klimatizimin preciz në sallën e sistemit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën prej 1 (një) viti, shpallja nr. 09763/2022
14. Parapagesa (subscription) vjetore e softuerit për pajisjet për mbrojtjen në të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV, shpallje nr. 12410/2022
15. Parapagesa vjetore e softuerit dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e softuerit për evidencën e ngjarjeve me regjistrat korelues të logove të pajisjeve IKT të vendosura në Gjykatën Supreme të RMV, shpallje nr.12411/2022
16. Furnizimi me materiale për zyrë dhe materiale të shtypura për periudhën prej 1 (një) vjet, shpallje nr.14829/2022
17. Sigurim kasko të PMV zyrtare të GJSRMV për periudhën prej 1 (një) viti, shpallje nr.16284/2022
18. Perde veneciane, shpallje nr.16686/2022
19. Parapagesë e softuerit vjetor, mirëmbajtja vazhdueshme e post garancisë së harduerit të centralizuar dhe softuerit sistemor për backup/restore qendrore të bazës së të dhënave të gjykatave në RMV, shpallje nr.16927/2022
20. Furnizimi me materiale për zyrë për periudhën prej 1 (një) viti, shpallje nr.17969/2022
21. Shërbime të lyerjes, shpallje nr.19064/2022
22. Parapagesë e softuerit vjetor, mirëmbajtja vazhdueshme e post garancisë së harduerit të centralizuar dhe softuerit sistemor për backup/restore qendrore të bazës së të dhënave të gjykatave në RMV, shpallje nr.19085/2022
23. Sigurim kasko të PMV zyrtare të GJSRMV për periudhën prej 1 (një) viti, shpallje nr.19659/2022
24. Karburant për nevojat e GJSRMV për periudhën prej 1 (një) viti, shpallje nr.19685/2022
25. Mirëmbajtja adaptuese dhe preventive e AKMIS sistemit të implementuar në të gjitha gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, shpallje nr.19941/2022
26. Sigurimi i mjeteve themelore (ndërtesës dhe pajisje) të GJSRMV, shpallje nr.21497/2022
27. Shërbime për furnizimin e biletave të avionit për periudhën prej 1 (një) viti, shpallje nr.21499/2022.

Furnizime grupore të realizuara sipas nenit 62 të Ligjit për prokurime publike

1. Furnizimi me energji elektrike për periudhën prej 1 (një) viti
2. Furnizimi me pajisje informatike për nevojat e Këshillit gjyqësor të RMV dhe të gjithë gjykatat në RMV
3. Furnizimi me shërbimin për telefona celular për periudhën pre 2 (dy) viteve
4. Energji elektrike për vitin 2023
5. Furnizimi me shërbime të internetit për periudhën prej 12 muajve
6. Energji elektrike për vitin 2023

Furnizime të filluara në vitin 2021 për të cilat procedura ka përfunduar në vitin 2022

1. Mirëmbajtja adaptuese dhe preventive e AKMIS sistemit të implementuar në të gjitha gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, shpallje nr.22346/2021
2. Furnizimi me shërbime të internetit për periudhën prej 12 muajve - Furnizimi grupor
3. Furnizimi me serverë të ri dhe IT pajisje tjera për funksionimin papengesë të AKMIS Sistemit me të gjitha mbindërtimet (furnizimi grupor), shpallje nr.18654/2021 – Furnizimi grupor

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE

1. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore në vitin 2022 i realizoi me një numër të vogël të gjyqtarëve dhe atë administratës gjyqësore. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut **vitin raportues 2022** e mbaroi si gjykatë efikase, **fluksin e lëndëve e kapërceu plotësisht, ndërsa zvogëloi numrin e lëndëve të mbetura për 149 lëndë.**

Në vitin 2022, Gjykata Supreme ka pasur gjithsej në punë **3069** lëndë nga të gjitha llojet, nga të cilat **8** lëndë janë evidentuar si përsëri në punë, **1** lëndë udhëhiqet si gabimisht e evidentuar. Bo 2022 година.

Viti ka filluar me **956** lëndë të pakryera nga viti 2021, ndërsa gjatë vitit janë pranuar **2106** lëndë të reja. Prej tyre janë kryer **2262** lëndë, ndërsa **807** lëndë kanë mbetur të pakryera.

2. Në Sektorin e veprave penale gjatë vitit raportues 2022, janë pranuar 598 lëndë të reja, nga viti i kaluar kanë mbetur 124 lëndë, apo gjithsej në punë 722 lëndë për të gjitha bazat, nga të cilat 653 janë kryer, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur 69 lëndë të pakryera për të gjitha bazat.

Nga gjithsej numri i lëndëve të pakryera, ndikim ka gjendja që 17 lëndë përkatësisht 24,63% të cilat janë dhënë për mendim në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk janë kthyer në Gjykatë deri më 31.12.2022, në mënyrë që të njëjtat edhe nuk janë vendosur gjatë vitit 2022, rrethanë kjo që ka ndikuar edhe në zvarritjen e procedurës për procedimin dhe vendimmarrjen e lëndëve të theksuara.

Në vitin 2022 për Regjistrin RKP – lëndë penale të ndryshme janë pranuar 30 parashtresa dhe për të gjitha është vepruar.

Në Sektorin e veprave penale gjatë vendimmarrjes dhe shkrimit të vendimeve dhe sentencave implementohet praktika e vendosur gjyqësore e Gjykatës Evropiane për Drejtat e Njeriut, për zbatimin unik të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe me atë edhe veprimi *erga omnes* i aktgjykimeve.

Këto rrethana objektive paraqesin edhe shkaqe të arsyetuara dhe relevante që ndikojnë në realizimin e principit të përditësimit dhe efikasitetit në procedimin e Sektorit.

3. Sektori i veprave civile, në periudhën raportuese ka pasur gjithsej në punë 1.760 lëndë, nga të cilat 617 lëndë janë të pakryera nga vitet e kaluara, ndërsa lëndë të reja të pranuar 1141. Në vitin raportues janë kryer 1103 lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur 657 lëndë. Fluksi nuk është kapërcyer në tërësi ndërsa numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera është rritur për 40 lëndë. për shkak të rritjes së punës efikase të gjyqtarëve ekziston mundësia që të plotësohet numri i vendeve të zbratura të gjyqtarëve.

4. Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm, në periudhën raportuese ka vepruar për 567 lëndë, për të gjitha bazat, në të dyja shkallët e vendimmarrjes. Nga viti i kaluar kanë mbetur 211 lëndë të pakryera, 351 lëndë janë pranuar të reja, 6 lëndë janë evidentuar si përsëri në punë dhe 1 lëndë është evidentuar gabimisht.

Gjatë vitit raportues **2022**, nga gjithsej 567 lëndët në punë, nga të cilat 351 lëndë të reja të pranuar, janë kryer 488 lëndë, dhe nga këtu mund të vijmë në përfundim se fluksi i lëndëve në Sektorin është kapërcyer për 137 lëndë. Njëkohësisht, duke marrë parasysh numrin e 211 lëndëve që kanë mbetur të pakryera në fund të vitit 2021 dhe numrin prej 79 lëndëve që kanë mbetur në punë në fund të vitit 2022, mund të konstatojmë se numri i lëndëve që kanë mbetur të pakryera është zvogëluar për 132 lëndë.

Në vitin raportues **2022**, krahasuar me vitin 2021, është rritur shuma e gjithsej kompensimit të caktuar në para, i shqiptuar për shkak të shkeljes së konstatuar për të drejtën e gjyqimit në afat të caktuar, megjithatë është rritur numri i lëndëve të kryera me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, (prej 106 lëndëve të miratuara për vitin 2021 në 169 kërkesa të miratuara për vitin 2022). Gjithsej kompensimi i caktuar, i shqiptuar për shkak të shkeljes së konstatuar për të drejtën e gjyqimit në afat të arsyeshëm, në vitin 2021 në shkallën e parë ka qenë 2.925.900 denarë, përderisa në shkallën e dytë ka qenë 480.875 denarë, përkatësisht shuma totale në të dyja shkallët ka qenë 3.406.775 denarë në krahasim me gjithsej kompensimin e shqiptuar për vitin 2022 në shumë prej 5.633.702 denarë. Lartësia e kompensimit të shqiptuar i nënshtrohet para se gjithash numrit të rritur të lëndëve të kryera, e megjithatë kjo shumë nuk shmanget nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke marrë parasysh kompensimet e caktuara nga GJEDNJ gjatë marrëveshjes miqësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut me aplikuesit. Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm bën vazhdimisht analiza dhe vlerësime juridike, me qëllim të korigjimit të lartësisë së kompensimeve të shqiptuara në lëndët ku është përcaktuar shkelja e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe afrimi ndaj kompensimit të shqiptuar të caktuar për lëndë të ngjashme nga GJEDNJ.

Duke marrë parasysh sipër të ekspozuarën mundemi të përmbledhim se gjyqtarët, këshilltarët gjyqësorë dhe të punësuarit në sportelin gjyqësor të Sektorit, gjatë vitit raportues 2022 kontribuuan që Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të jetë i përditësuar dhe efikas, duke marrë parasysh numrin e lëndëve në shkallën e parë dhe të dytë, për të gjitha bazat, si dhe numrin e zvogëluar të gjyqtarëve me të cilët disponoi Sektori në vitin raportues. Mënyra e këtillë e punës, jep të drejtën që Sektori edhe më tej të vazhdojë të punojë me mënyrën e vendosur të vendimmarrjes së lëndëve në afatin e arsyeshëm me përpunimin e vendimeve cilësore, si dhe me angazhimin për zgjidhjen e çështjeve rreth dorëzimit të shkresave të lëndëve për të cilat është parashtruar kërkesë për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, duke pasur qëllim respektimin e afateve të parapara ligjore.

5. Sektori i praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë vitit 2022, në një pjesë të konsiderueshme i ka realizuar detyrat e shënuara programore.

6. Konstatim gjeneral që rrjedh nga të dhënat e punës dhe angazhimit të gjyqtarëve, dhe për shkak të rritjes së efikasitetit nevojitet që të plotësohen vendet e zbratura të gjyqtarëve, ngase të gjithë gjyqtarët krahas punës me lëndët në sektor, kanë marrë pjesë në vendimmarrjen e kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në shkallën e parë dhe në këshillin e shkallës së dytë që vendos për ankesat kundër aktvendimeve të këshillit prej tre gjyqtarëve për kërkesat për gjykim në afat të arsyeshëm, në punën e Këshillit të specializuar që vendos për ankesë të kandidatit, i cili nuk është zgjedhur gjyqtarë, respektivisht Kryetar i Gjykatës, në Këshillin e specializuar për vendosjen e ankesave kundër Vendimeve të Gjykatës Administrative sipas nenit 62 të Ligjit për konteste administrative, me propozim për mbrojtjen për shkak të veprimit joligjor, në punën e Sektorit të praktikës gjyqësore së bashku me bashkëpunëtorët profesional gjyqësor.

7. NËpunësit profesional gjyqësor, gjatë vitit raportues 2022, treguan shkallë të lartë operative me gjyqtarët në përpilimin e planit të vendimeve, si dhe shkallë të lartë profesionale, me përgjegjësi dhe përditësim në kryerjen e obligimeve të veta, por edhe krahas kësaj për rritjen e efikasitetit në punën e Gjykatës, nevojitet plotësimi i vendeve zbrazura dhe të paplotësuara të punës nga radha e udhëheqësve dhe këshilltarëve profesional gjyqësor sipas Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës në Gjykatë dhe Ligjit për shërbimin gjyqësor.

8. Duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e nëpunësve gjyqësorë në Gjykatën Supreme, si gjykatë më e lartë në Republikë, në procesin e sigurimit të veprimit efikas të gjykatës, të bëhen tentime për ndryshimin e Ligjit për shërbim gjyqësor dhe përmes saj të sigurohen mundësi për avancimin, shpërblimin dhe rritjen e numrit të nëpunësve gjyqësorë, posaçërisht në numrin e realizuesve në sportelet gjyqësore dhe numrin e realizuesve në Qendrën e informatikës.

9. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas kompetencës së saj qëndrimet parimore dhe mendimet juridike parimore të miratuara, mendimet juridike dhe konkluzionet nga puna e Seancës së përgjithshme dhe mendimet juridike, konkluzionet dhe sentencat e miratuara në seancat e sektorëve, të vazhdojë në vazhdimësi ti publikojë në faqen zyrtare të Gjykatës, por edhe të vazhdojë praktikën e publikimit të Buletinit dhe të Përmbledhjes së vendimeve gjyqësore.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEANCA E PËRGJITHSHME**